

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7870 E enjte 2 Maj 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Samiti i Berlinit u thirr kryesisht për dialogun Serbi-Kosovë dhe si dëshmi e forcimit të boshtit franko-german dhe në rajonin tonë. Ndërsa për negociatat ...

Vijon në faqen 20

Nga JORGJI KOTE

"Topi" i negociatave në portën tonë!



Opinion i Ditës

Samiti i Berlinit ishte vetëm konfirmimi kokëfortë se sa mbrapa ka bërë Shqipëria nën qeverisjen e Edi Ramës. I rikthyer 5 vjet më vonë në Berlin, në formatin ...

Vijon në faqen 21

Nga BARDH SPAHIA

Pranvera djegëse e një kryeministri



"E vërteta e Samitit të Berlinit"

Rama, polemika me Ramush Haradinajn: Gënjen që të dalë i mirë para popullit

Kryeministri: Nuk i kërkova ta heqë taksën me Serbinë, por ta pezullojë përkohësisht

Kryeministri Edi Rama ka hedhur poshtë si të gënjeshtërt deklaraten e bërë nga kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj pas Samitit të Berlinit që u mbajt pak ditë më parë. Nëpërmjet një reagimi të gjatë në rrjetet sociale, Rama mohon që t'i ketë bërë presion Haradinajt që të heqë taksën, por thjesht i ka sugjeruar që të pranojë ofertën e ardhur ...

Në faqen 5

"RAMA IK" / 2 ORE PROTESTE, SHTOHET KOHEZGJATJA E MOSBINDJES CIVILE

OPOZITA BLOKON SOT RRUGET NE 12 QARQE

Basha takon Kryemadhin: Nuk ka dialog pa u larguar Rama si kryeministër. Publikohet sot dokumenti për qeverinë transitore. Patozi: Kundërshtar kemi Ramën



(Në foto) Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi dhe Kryetari i PD, Lulzim Basha, duke dalë nga selia e LSI

Në faqen 2-3

PETICIONI

Naftëtarët, letër Ramës: Kërkojmë shtesë 40% të pagës minimale

Në faqen 6

LISTA E PLOTE

Legalizimet, 480 familjet që marrin lejet në qarkun e Vlorës

Në faqen 8-9

PRESIDENTI I KOSOVES

Samiti i Berlinit, Thaçi: Pati shumë fjalime boshe dhe asgjë konkrete

Në faqen 14

DIPLOMACI

Arkivat e MPJ-së italiane, çfarë kërkonin shqiptarët në vitin 1912

Në faqen 18

KRIMI NE SELITE



Vrasja e ish-officerit të policisë, pranga 47-vjeçarit. Dyshimi: U dha makinën autorëve

Në faqen 7

EMRAT/ Familjet që ndërtuar në tokën e shtetit ose të të tretëve

500 pronarët që marrin tapinë e truallit

Emrat e përfituesve në Tiranë, Durrës, Elbasan, Shkodër dhe Korçë

Miratohet lista me personat që kanë ndërtuar pa leje dhe fitojnë të drejtën e pronësisë mbi sipërfaqet ndërtimore. Me një vendim të veçantë, qeveria ka përcaktuar metra katrorë për parcelat ndërtimore në Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan dhe Korçë. Janë 500 përfitues



në të gjithë vendin, të cilët do të marrin tapinë për truallin mbi të cilin kanë ndërtuar. Në listën e miratuar nga qeveria janë përcaktuar sipërfaqet për çdo përfitues, ndërsa ngarkohet ALUIZINI për pasqyrimin e tyre në dokumentet përkatëse...

Në faqen 16-17

PROTESTA OPOZITA

Zgjerohet harta e bllokimit të qarkullimit, opozita fton qytetarët në protestë

Opozita bllokoi sot rrugët për dy orë në 12 qarqe të vendit

"Rama ik", shtohet kohëzgjatja e mosbindjes civile

Opozita e bashkuar ka vendosur të përshkallëzojë sot aksionin, duke bllokuar për afro dy orë akset kryesore të rrugëve në 12 qarqe të vendit. Ky vendim u mor dje pas takimit që kreu demokrat, Lulzim Basha, zhvilloi me aleatët. Në një prononcim për mediat, kreu i PD-së, Lulzim Basha bëri të qartë se kjo formë proteste vjen si një intensifikim dhe përshkallëzim i mosbindjes civile. Në orën 18.00, opozita u ka bërë thirrje qytetarëve t'i bashkohen përshkallëzimit të protestës për të kërkuar largimin e kryeministrit Edi Rama, si personi përgjegjës, sipas saj, për bashkëpunimin me krimin në blerjen e votës. Ndryshe nga e enjtja e kaluar, bllokimi do të shtrihet në të 12 qarqet e vendit. Herën e shkuar u bllokuan vetëm 5 akse dhe për një orë, por këtë herë opozita ka vendosur do të bllokojë qarkullimin e makinave për dy orë, nga 18:00-20:00. Të gjitha degët e partive opozitare janë lajmëruar dhe organizuar për të qenë prezentë në akset e duke i bllokuar si pjesë e radikalizimit të qëndrimeve të PD-së dhe aleatëve të saj përballë refuzimit të kërkesave të bërë për krizën politike. Qeveria transitore dhe shtyrje e zgjedhjeve lokale, duke synuar që njëherësh që të mbahen edhe zgjedhjet e përgjithshme të parakohshme janë kushtet kryesore të opozitës.

BLLOKIMI
Në Shkodër, për tri qytete që përfaqëson ky qark protestuesit do të dalin në vendin e quajtur Krye-Bushati, ku kalon rruga kombëtare. Një gjë e tillë është paralajmëruar nga vetë kryetari i degës së PD-së, Xhevdet Amuli, ku u bëhet thirrje të gjithë protestuesve të zonës së veriu të mblidhen pikërisht në këtë aks rrugor. Në Lezhë bllokimi i rrugës do të bëhet si herën e shkuar, në rreth-rrotullimin pranë Milotit, që lidh dhe rrugën kombëtare me atë të Kosovës. Në qarkun Dibër, në rrugën që lidh Peshkopinë me Bulqizën. Gjithashtu, mësohet se pesë akset e rrugëve që u bllokuan të enjten shkuan do të jenë sërish qendra e protestës edhe sot. Grumbullimi i protestuesve të qarkut të Tiranës do të jetë në rreth-rrotullimin e sheshit "Shqiponja", ndërsa



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, javën e kaluar në Milot

PROTESTA E OPOZITËS, AKSET QË DO BLLOKOHEN NË 12 QARQET E VENDIT

- Qarku Kukës - Ura e Drinit në hyrje të Rrugës së Kombit.
- Qarku Shkodër - Në zonën e quajtur Krye-Bushat.
- Qarku Lezhë - Në rrotullimin e rrugës së Milotit, ku lidhet rruga me Kosovën.
- Qarku Dibër - Bllokim në rrugën që lidhet me Bulqizën.
- Qarku Tiranë - Rreth-rrotullimi i sheshit "Shqiponja".
- Qarku Durrës - Aksi Durrës-Kavajë, në rreth-rrotullimin pranë vendit të quajtur zona e Plepave.
- Qarku Elbasan - Në Bradashesh pranë karburant "Gega".
- Qarku Fier - Ura e Mbrostarit- rreth-rrotullimi i "Sheqit".
- Qarku i Beratit - Grumbullimi tek Ura e Hanit.
- Qarku Korçë - Tek rreth-rrotullimi në Çiflig, në hyrje të Korçës.
- Qarku Vlorë - Rruga në hyrje të Superstradës Vlorë- Levan.
- Qarku Gjirokastrë - Ura Leklit në Tepelenë.



Një nga protestat e opozitës për bllokimin e rrugëve

Ndryshimi

Ndryshe nga e enjtja e kaluar, bllokimi do të shtrihet në të 12 qarqet e vendit. Herën e shkuar u bllokuan vetëm 5 akse dhe për një orë, ndërsa sot opozita ka vendosur do të bllokojë qarkullimin e makinave për dy orë, nga 18:00-20:00.

Thirrja

Në orën 18:00, opozita u ka bërë thirrje qytetarëve t'i bashkohen përshkallëzimit të protestës për të kërkuar largimin e kryeministrit Edi Rama, si personi përgjegjës, sipas saj, për bashkëpunimin me krimin në blerjen e votës.

LSI: Qeveria bllokoi integrimin, Shqipëria problem edhe për Kosovën

Lëvizja Socialiste për Integrim akuzoi dje qeverinë për moshapjen e negociatave të anëtarësimit me BE. Ish-kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, Petrit Vasili, tha se në Shqipëri për shkak të qeverisjes së saj, të gjithë fenomenet negative janë rënduar siç është krimi, korrupsioni, krimi zgjedhor etj. Nga Berlini, qytetarët shqiptarë sipas Vasilit kanë mësuar se Shqipëria është një nga problemet kryesore edhe për Kosovën. "Integrimi është një prioritet madhor, është prioritet profesional në radhë të parë. Është prioritet politik. Sigurisht që në këtë proces Shqipëria nuk mund ta banalizojë si një vit më parë. Ky kryeministri duartrokoi



Gazmend Bardhi

Gjatë takimit me të rinjtë e njësisë nr.7 që i bashkohen PD-së, Bardhi u shpreh se beteja e ndërmarrë nga opozita, nuk është betejë për pushtet, por betejë për Shqipërinë. "Apeli im i fortë, duke vlerësuar angazhimin e deritanishëm, kemi ende rrugë përpara për të bërë. 11 Maji. Ju ftoj të angazhohemi e të bindim çdo qytetar. Shpjegojani, nuk po bëjmë betejë për të sjellë PD në pushtet. Atë do e bëjmë kur të ketë zgjedhje të ndershme", tha Bardhi.

ste për gjëra të cilat nuk u arritën, ku dhe për humorin e të gjithë shqiptarëve, po ua kujtoj edhe sot, në 29 qershor ai dekoronte edhe katër ambasadorë të tij, sepse këta kishin arritur të rregullonin çështjet e Europës, të mbyll-

nin negociatat dhe të bënin gjithçka dhe sot ja ku jemi, kemi 4 medalje ambasadorësh, por nuk kemi Integrim European, përkundrazi jemi bërë problem i madh edhe për Kosovën", deklaroi z.Vasili.

për ato të Durrësit në zonën e Plepave. Demokratët e qarkut Fier do të mblidhen tek ura e Mbrostarit në rrugën në hyrje të qytetit,

ndërsa demokratët e Beratit do të mblidhen tek Ura e Hanit, në pjesën e rrugës së Perondisë. Opozita do të protestojë edhe tek rreth-rrotullimi

në Çiflig, në hyrje të Korçës, si dhe në rrugën në hyrje të superstradës Vlorë-Levan. Për qarkun e Gjirokastrës, protesta është do të bëhet tek



BD, kandidatë në çdo bashki në zgjedhje

Patozi: Nuk rivalizojmë kandidatët e djathtë, kundërshtar kemi Ramën

Partia "Bindja Demokratike" e Astrit Patozit nuk do të garojë në bashkitë e djathta, ku ka kandidatë të pavarur për zgjedhjet vendore të 30 qershorit. Në një deklaratë për mediat ditën e djeshme, Patozi deklaroi se ky vendim është marrë, sepse bashkimi i forcave opozitare do të rrezonte Ramën. Në prag të zgjedhjeve vendore të 30 qershorit, kur opozita vijon me vendimin për bojkot, kryetari i partisë më të re opozitare, tha se nuk do të rivalizojë kandidatët e djathtë, duke mos vendosur emra përballë tyre. Sipas Patozit, "Bindja Demokratike do të bëjë një betejë frontale, duke u përballur me të gjithë kandidatët e mazhorancës dhe në çdo bashki BD do të ketë kandidatë. Patozi shprehu vendosmërinë për t'u përfaqësuar në zgjedhjet vendore të 30 qershorit. "Betejë frontale duke u përballur me të gjithë kandidatët e mazhorancës. Në çdo bashki do të kemi kandidatë. Do mbështesim kandidatët e pavarur të bashkive të djathta, sepse bashkimi i forcave opozitare do të rrezonte Ramën. Nuk garojmë në bashkitë ku ka kandidatë të pavarur. Edhe 'Bindja Demokratike' do të përfaqësohet nga kandidatë të pavarur", u shpreh z. Patozi. Ai nënvizoi se pjesëmarrja në zgjedhje është rruga e vetme për të rrezuar qeverinë Rama.

Ura Leklit në Tepelenë. Ky është një skenar i përsëritur nga opozita, pasi edhe në datë 24 prill, ajo bllokoi akset kryesore që lidhin veriu

dhe jugun me Tiranën. Opozita bllokoi për një orë rrugën duke mos lejuar qarkullimin e mjeteve në këto akse.



Aksioni i opozitës, kreu i PD-së në selinë e LSI dhe PDIU: Garantojmë zgjedhje të lira

Takimi me Ramën? Basha: S'ka dialog pa dhënë dorëheqjen nga qeveria

"Oferta jonë për nxjerrjen e vendit nga kriza"

Valentina Madani

Opozita e bashkuar sot në orën 11:00 do të prezantojë në një program të detajuar, se cilat do të jenë detyrat e qeverisë tranzitore, ku në thelb mbeten sigurimi i zgjedhjeve të lira. Po sot opozita do të përshkallëzojë mosbindjen civile, duke bllokuar akset kombëtare në 12 qarqet e vendit. Në funksion të kësaj, kreu i PD-së Lulzim Basha pati dje takime intensive me aleatët. Fillimisht i shkoi në zyrë për afro një orë kryetares së LSI-së, Monika Kryemadhit dhe më pas kreut të PDIU-së Shpëtim Idrizit, ndërkohë që në pasditen e djeshme mbledhi të gjithë aleatët në selinë e PD-së. Për afro 60 minuta takim, z.Basha bëri të ditur për mediat se kishte diskutuar me aleatën e tij vijimin e aksionit opozitar dhe mënyrën sesi do të funksionojë qeveria tranzitore. Basha paralajmëroi përshkallëzim të mosbindjes civile deri në largimin e kryeministrit Rama. "Do të vazhdojmë aksionin tonë në të gjitha plan-et. Nesër (sot)nga ora 18:00 do të nisë aksioni në 12 qarqet e vendit për bllokimin e akteve kryesore si një intensifikim dhe përshkallëzim i mosbindjes civile", njoftoi z.Basha. I pyetur nëse do të ulet në një tryezë të inicituar nga presidenti me Edi Ramën si kryetar i PS, Basha tha se nuk do ketë dialog pa dhënë më parë dorëheqjen si kryeministër. "Asgjë nuk ka ndryshuar në qëndrimin e opozitës së bashkuar dhe të koalicionit tonë politik, koalicionit më të madh, mazhorancës së re numerike, politike dhe morale të vendit. Largimi i Edi Ramës është kusht i panegociueshëm për t'i hapur rrugën dialogut politik, që do të çojë drejt qeverisë tranzitore", deklaroi z.Basha.



Kreu i PD-së Lulzim Basha dhe kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

OFERTA
"Ne do të shpalojm bashkë me koalicionin tonë opozitar detyrat e qeverisë tranzitore për të garantuar zgjedhje të lira dhe të ndershme dhe ndërkohë po punojmë intensivisht për programet tona politike, ekonomike, ofertën tonë për shqiptarët jo vetëm për ta nxjerrë vendin nga kriza", - deklaroi z.Basha.

KËRKESA

"Asgjë nuk ka ndryshuar në qëndrimin e opozitës së bashkuar dhe të koalicionit tonë politik, koalicionit më të madh, mazhorancës së re numerike, politike dhe morale të vendit. Largimi i Edi Ramës është kusht i panegociueshëm për t'i hapur rrugën dialogut politik, që do të çojë drejt qeverisë tranzitore", deklaroi z.Basha.



Sot prezantimi, zbardhet dokumenti i PD për detyrat e qeverisë tranzitore

Opozita e bashkuar do të publikojë sot në orën 11:00 dokumentin me detyrat e qeverisë tranzitore. Partia Demokratike, në bashkëpunim me aleatët e saj, prej kohësh po punon për hartimin e një platforme të detyrave, që do të ketë qeveria tranzitore. Duke e cilësuar si kusht të panegociueshëm për të hyrë në zgjedhjet vendore krijimin e një qeverie tranzitore, demokratët janë duke punuar dhe do të prezantojnë detyrat që do të ketë kjo qeveri. Sipas burimeve nga grupi i punës që është duke punuar për këtë platformë, detyra kryesore që do të ketë kjo qeveri e mandatar me konsensusin e të gjithë aktorëve politikë do të jetë përgatitja e zgjedhjeve të parakohshme. Demokratët pritet të kërkojnë që kjo qeveri të punojë me një afat 3-6 muaj deri në zhvillimin e zgjedhjeve. Gjithashtu, pritet që të kërkoher për depolitizim të komisioneve zgjedhore. Në fokus të qeverisë tranzitore do të jetë edhe miratimi i Kodit të ri Zgjedhor, nga i cili aktualisht, për shkak të lënies së mandateve, janë të përjashtuar PD dhe LSI. Demokratët, përmes prezantimit të detyrave të qeverisë tranzitore do të kërkojnë të tregojnë se beteja e tyre është bërë jo për të marrë pushtet në tavolinë, por për të instaluar në vend një demokraci europiane. Disa ditë më parë, Lulzim Basha prezantoi edhe pikat e forta që do të ketë qeveria e demokratëve, pasi të marrë besimin e shqiptarëve. Basha deklaroi se sektori i shëndetësisë do të jetë prioritar gjatë qeverisjes së PD-së, duke premtuar rroga minimale 700 euro për infermierët dhe 1200 euro për mjekët. Gjithashtu, demokratët kanë premtuar se do të anulohet të gjithë koncesionet korruptive në sektorin e shëndetësisë dhe do të rrisin shpenzimet për rikonstruksionin e qendrave spitalore dhe shtimin e stafëve mjekësore. Po ashtu, Basha ka premtuar se gjatë qeverisjes së demokratëve do të rritet edhe vlera e rimbursimit të medikamenteve.

"Meta është me ne, qytetarët do të rrëzojnë Ramën"

Aleatët e PD: Zgjedhjet pa opozitën, rrezik për stabilitetin në vend

Aleatët e Partisë Demokratike, tashmë pjesë e grupimit të qendrës së djathtë, konsiderojnë se tani u takon qytetarëve të japin betejën e tyre për rrëzuar qeverinë, teksa e shohin qëndrimin e presidentit në një linjë me shqetësimet e tyre. Dashamir Shehi këmbëngul në ndryshimin e sistemit zgjedhor, një nga pikat që aleatët e vegjël nuk kanë gjetur dakordësi me Partinë Demokratike. Në ndalësën e dytë të forumit për zgjedhje të lira, organizuar në Durrës, ata u kërkuar qytetarëve të angazhohen në moslejimin e zgjedhjeve farsë si dhe t'i bashkohen protestës së opozitës në datën 11 maj. "Zgjedhjet pa opozitën përbejnë një rrezik të



madh për stabilitetin e vendit si dhe cenojnë pluralizmin politik. Dalja nga kjo krizë mund të vijë vetëm nëpërmjet një marrëveshjeje afatgjatë, me të cilën të ndërmerren ndryshime kushtetuese që do të kufizojnë dhe kontrollojnë autoritetin e pushtetarëve. Që

do të krijojë më shumë hapësira dhe respektim të plotë për liritë dhe të drejtat e qytetarëve, një ligj zgjedhor me lista të hapura, kufizimi i mandateve, reformë kushtetuese dhe administrative", deklaroi z.Medi. Aleatët e Partisë Demokratike u bënë thirrje qytetarëve të angazhohen në moslejimin e zgjedhjeve farsë si dhe t'i bashkohen protestës së opozitës në datën 11 maj. Aleatët e qendrës së djathtë u takuan të martë me Presidentin Ilir Meta, ku diskutuan për lidhje me krizën politike në vend. Gjatë takimit, aleatët morën garanci nga Presidenti Ilir Meta për organizimin e një tryeze politike mes opozitës dhe mazhorancës, me qëllim që t'i jepet fund krizës politike në vend.

TAKIMI

Pas takimit me Monika Kryemadhin, kryetari i demokratëve shkoi në zyrën e Shpëtim Idrizit, të PDIU-së. "Opozita ka punuar për një platformë të përbashkët ku do të bëhen të qarta të gjitha fenomenet negative që ndodhin në zgjedhje, nga vjedhja, intimidimi dhe përdorimi i pushtetit në zgjedhje. Sot janë 160 mijë të punësuar në shtet, janë shtuar 40 mijë vota gjatë kësaj periudhe, ndërkohë që janë larguar në mënyrë të padrejtë mbi 20 mijë vota. Opozita e bashkuar po punon

për programin elektorale dhe ekonomik ku të gjitha forcat politike që përbejnë këtë aleancë kanë përparësitë e tyre dhe duhet rakorduar drejt një modeli të ri ekonomik, sepse Shqipëria i ka të gjitha resurset", deklaroi z.Idrizi. Kreu i PDIU iu përgjigj interesit të medias pse ai nuk është pjesë e partive që u takuan me presidentin dhe që kërkojnë tryezë dialogu. "Sigurisht ne kemi një marrëveshje me PD-në, por çdo forcë politike dhe grupim ka të drejtën e vet të japë kontributin e vet në zgjedhjen e

krizës. Nuk kemi pasur nevojë, përveç aleancës me PD-në të potencojmë apo të kemi mundësi të tjera të bëhemi pjesë e opozitës së bashkuar", u shpreh kreu i PBDNJ-së. Të martën aleatët e Lulzim Bashës i kërkuar kreut të shtetit të thërrasë në një tryezë dialogu të gjitha partitë politike, ku Edi Rama të ishte i përfaqësuar në cilësinë e kreut të PS, me qëllim arritjen e një marrëveshjeje kushtetuese që do t'i jepte fund krizës politike pas djegies së mandateve nga ana e opozitës.

NEGOCIATAT GJERMANIA

Nënkryetari i grupit CDU/CSU konfirmon shtyrjen e vendimit për Shqipërinë

Deputeti i Merkel: Negociatat në shtator, PD të mos mbyllet përgjithmonë

"Demokrati do të thotë komunikim, grindje, kompromis"

Deputeti gjerman i partisë së Merkel, Johann Wadepuhl, i cili mban edhe pozicionin e nënkryetarit të grupit parlamentar CDU/CSU në Bundestag në një intervistë të dhënë për Deutsche Welle ka folur për negociatat Serbi-Kosovë, zgjidhjen e krizës në Shqipëri dhe çeljen e negociatave të Shqipërisë me BE. Ai konfirmoi lajmin që prodhoi, në fakt, edhe samiti i Berlinit se vendimi për hapjen e negociatave të anëtarësimit për Shqipërinë do merret në shtator. "Ne jemi në pritje të rekomandimit të Komisionit të BE-së dhe ky do të na vijë pas zgjedhjeve evropiane. Prandaj, sipas gjasave, nuk do të jemi në gjendje që t'i organizojmë konsultat deri në qershor. Vendimi do të merret në shtator. Por parimisht u kemi thënë të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor se janë pjesë e Evropës dhe se e kanë vendin në Bashkimin Evropian", - tha ai.

Por, nga ana tjetër, ai ka përcjellë edhe një mesazh për opozitën në Tiranë duke i bërë apel asaj që të përfshihet në proceset politike. Duke lënë të kuptohet qartë se është kundër bojkotit të parlamentit dhe zgjedhjeve lokale të 30 qershorit. "Dëshiroj ta inkurajoj atë të marrë pjesë në proceset politike. Ne nuk mund ta sjellim Shqipërinë në Bashkimin Evropian nëse forcat evropiane qofshin ato pro-Rama, qofshin pro-Basha, janë në konflikt me njëra-tjetrën. Duhet bërë një afrim në një farë mënyre. Sesi do të vendoset në Shqipëri. Unë mund të them në drejtim të partisë simotër: Mos u mbyllni përgjithmonë! Kush kalon portën për të dalë jashtë, duhet ta kalojë atë sërish për të hyrë brenda. Demokrati do të thotë komunikim, grindje, por edhe aftësi për kompromis. Pa kompromis nuk ka demokraci", u shpreh Johann Wadepuhl.

Zoti Wadepuhl, cili është vlerësimi juaj për samitin e Ballkanit Perëndimor në Berlin?

Samiti ishte shumë pozitiv. U gëzova shumë që erdhën kaq shumë liderë nga



Deputeti gjerman i partisë së Merkel, Johann Wadepuhl

rajonit për të biseduar me kancelaren Merkel dhe presidentin Macron. Ishte një impuls i rëndësishëm që Angela Merkel me Emmanuel Macron dhanë dhe ky impuls tani duhet të merret nga vendet e rajonit. Dhe sidomos mes Serbisë dhe Kosovës na nevojiten negociata shumë konkrete.

Si mendoni ju se mund të zgjidhet konflikti Serbi-Kosovë?

Problemi i njohjes nuk

mund të zgjidhet brenda ditës, askush nuk e pret këtë. Por mund të flitet për çështje të veçanta, për trashëgiminë kulturore, për mbrojtjen e pakicave, për asociacionet e komunave. Tani është e rëndësishme që të dyja palët të bisedojnë e të mos ngecen në ca grindje të panevojshme për terri-tore. Këto janë çështje të dorës së dytë. Nëse negociatat do të fillojnë tani me zgjidhjen e këtyre çështjeve

APELI

"Dëshiroj ta inkurajoj atë të marrë pjesë në proceset politike. Ne nuk mund ta sjellim Shqipërinë në Bashkimin Evropian, nëse forcat evropiane, qofshin ato pro-Rama, qofshin pro-Basha, janë në konflikt me njëra-tjetrën. Duhet bërë një afrim në një farë mënyre. Sesi do të arrihet kjo, kjo do të vendoset në Shqipëri. Unë mund të them në drejtim të partisë simotër: Mos u mbyllni përgjithmonë!"

praktike dhe shumë konkrete, atëherë kjo është një shenjë e mirë. Gjithsesi, ishte një nisim e rëndësishme nga Parisi dhe Berlini, sepse tani mund të rifillojnë negociatat.

Ju u takuat edhe me kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Kur mund të shprejë Shqipëria të marrë "po"-në e grupit parlamentar CDU/CSU për çeljen e negociatave?



NEGOCIATAT

"Ne jemi në pritje të rekomandimit të Komisionit të BE-së dhe ky do të na vijë pas zgjedhjeve evropiane. Prandaj, sipas gjasave, nuk do të jemi në gjendje që t'i organizojmë konsultat deri në qershor. Vendimi do të merret në shtator. Por parimisht u kemi thënë të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor se janë pjesë e Evropës dhe se e kanë vendin në Bashkimin Evropian. Dhe, nëse Shqipëria i përbush kushtet për çeljen e negociatave, edhe ne do ta japim votën tonë pozitive në Bundestagun gjerman, duke i mundësuar qeverisë gjermane që të votojë në nivel evropian".

mundësi për ta zgjidhur krizën?

Zgjidhje ka gjithmonë. Zhvillimi aktual është i keq. Është problematike që PD-ja nuk mund të marrë pjesë në parlament me deputetët që janë zgjedhur në të vërtetë. Dikur ajo duhet të guxojë një fillim të ri. Unë besoj se është e rëndësishme që Shqipëria të gjejë veten. Prandaj u them partive pro-europiane që të arrijnë kompromise në nivel kombëtar dhe të vijnë së bashku në Evropë.

Mos është ky një apel për kolegët e partisë simotër, pra, për Bashën, që ai të marrë pjesë në zgjedhjet lokale?

Nuk do të dëshiroja të ndërhyja në raportet personale të PD-së në Shqipëri. Por dëshiroj ta inkurajoj atë të marrë pjesë në proceset politike. Ne nuk mund ta sjellim Shqipërinë në Bashkimin Evropian nëse forcat evropiane qofshin ato pro-Rama, qofshin pro-Basha, janë në konflikt me njëra-tjetrën. Duhet bërë një afrim në një farë mënyre. Sesi do të arrihet kjo, kjo do të vendoset në Shqipëri. Unë mund të them në drejtim të partisë simotër: Mos u mbyllni përgjithmonë! Kush kalon portën për të dalë jashtë, duhet ta kalojë atë sërish për të hyrë brenda. Demokrati do të thotë komunikim, grindje, por edhe aftësi për kompromis. Pa kompromis nuk ka demokraci. DW

Hahn: Koha për të integruar në BE Ballkanin Perëndimor

Komisioneri i Zgjerimit të Bashkimit Europian, Johannes Hahn vlerëson se Ballkani Perëndimor duhet të jetë pjesë e Bashkimit Europian. Në 15-vjetorin e zgjerimit të fundit të Bashkimit Europian, Komisioneri për Zgjerimin thekson se është koha për finalizimin e këtij projekti historik duke integruar dhe Ballkanin Perëndimor. Në një postim në Twitter, Hahn shkruan se festojmë 15 vjetorin e zgjerimit të BE-së, një projekt ambicioz në bazë të përpjekjeve të përbashkëta. "Sot (dje) ne festojmë 15-vjetorin e zgjerimit të BE-së, një projekt ambicioz në bazë të



përpjekjeve të përbashkëta dhe një vizioni të përbashkët për të ribashkuar kontinentin evropian dhe për të ruajtur paqen, prosperitetin dhe sigurinë për të gjithë qytetarët e BE-së. Ky vizion u bë realitet dhe tani është koha për të parë përpara dhe për të finalizuar projektin historik

të Bashkimit Europian duke integruar Ballkanin Perëndimor". Hahn shprehet i sigurt se me përpjekje të përbashkëta nga të dyja palët do të jetë gjithashtu një histori suksesi, për BE dhe Ballkanin Perëndimor. "Më të fortë së bashku!", -shkroi më tej Hahn në mesazhin e tij. Pavarësisht këtij mesazhi duket se për vendet e Ballkanit Perëndimor po bëhet gjithnjë e më e vështirë integrimi në BE. Dhe kjo si për shkak të realizimit të kushteve nga vendet aspirantë, por tashmë edhe për shkak të forcimit të zërit kundër zgjerimit nga forca të ekstremit politik evropian.

A i ka plotësuar Shqipëria kushtet për çeljen e negociatave?

Duhet të presim njëherë raportin e Komisionit të BE-së. Unë këtë nuk e njoh. Duhet ta lexoj dhe të shoh situatën në vend. Unë konstatoj se bëhen përparime, por ka ende për të bërë në luftën kundër korrupsionit dhe ndërtimit e shtetit të së drejtës. Sot e kam të vështirë të jap një vendim. Prandaj them se duhet të ecet përpara. Kush dëshiron të hyjë në BE, duhet të afrohet me standardet evropiane, dhe kjo nuk ka ndodhur ende në atë masë që ne e konsiderojmë të duhur. Por ka shumë shanse që të arrihet.

Shqipëria është momentalisht në një krizë ku është përfshirë edhe partia simotër e partisë suaj, PD-ja. A shihni ndonjë



Pak javë më parë parlamenti holandez votoi një dokument që kërkonte aktivizimin e mekanizmit për rikthimin e vizave për Shqipërinë. Dhe shkak për këtë u bë kërkesa e disa deputetëve holandezë, të cilët shprehën bindjen se lëvizja e lirë e shqiptarëve kishte sjellë më shumë kriminalitet në Holandë. Por për të konstatuar situatën në terren dhe gatishmërinë e institucioneve shqiptare për të luftuar krimin e organizuar, do të mbërrijnë në Tiranë javën e ardhshme një grup deputetësh holandezë. Ata do të vijnë në Tiranë në datat 6 dhe 7 maj për të parë nga afër ecurinë e reformave sidomos në fushën e drejtësisë dhe zhvillimet politike në Shqipëri. Vizitën e tyre e njoftoi para pak ditësh ish-ambasadori holandez i OSBE-së në Tiranë Robert Borch, i cili theksoi se kjo vizitë e

Delegacioni i Holandës do jetë në Tiranë në 6 dhe 7 maj

Rikthimi i vizave për shqiptarët, deputetët holandezë vijnë në Tiranë



parlamentarëve holandezë ishte një mundësi e mirë për Shqipërinë për të treguar të kundërtën e asaj që thonë forcat ekstremiste në Holandë për Shqipërinë dhe shqiptarët. "Një delegacion nga Holanda do të vizitojë

Shqipërinë muajin që vjen, e kjo është një mundësi e mirë për të treguar progresin që jeni duke bërë. Kjo duhet bërë në mënyrë konstruktive dhe pa doza propagande. Realiteti mjafton dhe s'ka nevojë për propagandë",

tha gjatë një interviste për mediat shqiptare Bosch. Megjithatë nuk është publikuar axhenda, mendohet se do të kenë takime me kryeministrin Edi Rama dhe kryetarin e opozitës Lulzim Basha. Ardha e tyre vjen në prag të publikimit të raportit për çeljen e negociatave të Shqipërisë me Bashkimin Europian dhe pak javë pasi parlamenti holandez miratoi një rezolutë për t'i kërkuar Brukselit rikthimin e vizave për shqiptarët. Ndërkohë që duhet thënë që edhe në vitet e kaluara, Holanda ka qenë një vend skeptik për sa i përket integritetit të Shqipërisë në BE.

Kryeministri ka rrëfyer të vërtetën e tij për diskutimet në Samitin e Berlinit

Rama: Ramushi gënjen për të dalë burrë i mirë para popullit të vet

"Udhëheqësit nuk i komentojnë në publik bisedat mes tyre"

Kryeministri Edi Rama ka hedhur poshtë si të gënjeshtërt deklaratën e bërë nga kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj pas Samitit të Berlinit që u mbajt pak ditë më parë. Nëpërmjet një reagimi të gjatë në rrjetet sociale, Rama mohoi që t'i ketë bërë presion Haradinajt që të heqë taksën, por thjesht i ka sugjeruar që të pranohet ofertën e ardhur nga Kancelarja Merkel dhe Presidenti Macron për pezullimin e saj. Në këtë reagim kryeministri Rama thekson se nuk është e hijshme që liderët të nxjerrin në shesh bisedat që bëhen në takime, aq më shumë kur ato janë informale.

REAGIMI I RAMËS

E vërteta ime me shumë dëshmitarë

Si rregull udhëheqësit nuk i komentojnë në publik bisedat mes tyre e sidomos ato informale, aq më tepër pa rënë dakord paraprakisht dhe lëre pastaj t'i shtrëmbërojnë, duke gënjyer për të dalë "burra të mirë" para popullit të tyre, si të ishin duke shitur mish në pazar. Më vjen sinqerisht keq që miku im Ramush, nuk e ka mësuar ende këtë rregull kaq të thjeshtë, megjithatë normalisht ky është as ndonjë rregull udhëheqësish në fakt, po një normë elementare mirëkuptimi njerëzor. Nuk është hera e parë që e bën, po është hera më e gabuar dhe prandaj këtë herë, së kaloj dot në heshtje si të tjera. Askush s'i ka bërë Ramushit presion në Berlin për të hequr taksën. Unë jo e jo. Madje askush as ia ka kërkuar hiç që ta heqë taksën! Unë jo e jo. Përkundrazi. Kancelarja Merkel dhe Presidenti Macron, kanë nxitur një diskutim informal në



Kryeministri Edi Rama dhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj

KËRKESA

Askush as ia ka kërkuar hiç që ta heqë taksën! Unë jo e jo. Përkundrazi. Kancelarja Merkel dhe Presidenti Macron, kanë nxitur një diskutim informal në holl mbi rifillimin e dialogut. Kam ndërhyrë vetëm njëherë, duke thënë se ata duhet të hynin vetë në proces. Më tutje i kanë kërkuar me shumë durim dhe disa herë Ramushit jo ta heqë taksën, po thjesht të japë pëlqimin që taksa të pezullohet përkohësisht, për 6 muaj apo edhe për 4 muaj qoftë, duke u zotuar që të

holl mbi rifillimin e dialogut. Kam ndërhyrë vetëm njëherë, duke thënë se ata duhet të hynin vetë në proces. Më tutje i kanë kërkuar me shumë durim dhe disa herë Ramushit jo ta heqë taksën, po thjesht të japë pëlqimin që taksa të pezullohet përkohësisht, për 6 muaj apo edhe për 4 muaj qoftë, duke u zotuar që të

hynjë në procesin e dialogut Kosovë-Serbi ata vetë. Edhe të dy personalisht, kancelarja dhe presidentit!

I kam sugjeruar Ramushit në dy momente ta pranohet këtë kërkesë të tyre, sepse kam menduar dhe mendoj që përfshirja direkte në nivelin më të lartë e Gjermanisë dhe Francës, boshitit të Bashkimit Europian, u shfaq si një

Çfarë tha Haradinaj për Ramën dhe Thaçin pas samitit

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, duke folur pas Samitit për "T7" deklaroi se presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i kanë bërë presion me shumë se Vuçiqi në sy të të gjithëve në Berlin për ta hequr taksën ndaj Serbisë. Ai deklaroi se Thaçi dhe Rama duke folur në një gjuhë që e njohim të gjithë në këtë takim i kanë kërkuar që të pranohet kërkesën e dy liderëve botërore, Merkel dhe Macron që të hequr taksën, cka sipas tij nuk ishte e drejtë. "Isha krejtësisht i vetëm në një qëndrim. Ma së fshtiri ish. Edhe presidenti, edhe Edi Rama më shumë bënin presion ata dy me e heq taksën, sesa shtetë tjera. Të gjithë insistonin që me respektu qëndrimin e kancelares dhe Macronit, që ky është një shans i mirë për Kosovën e që nuk duhet me e humb. Një insistim direkt i pandalshëm. Në një gjuhë që ishte në anglisht, që e merrnin vesh, edhe kancelarja edhe presidenti Macron. Kam dalë keq. Ma mirë ka qenë që Edi edhe Hashimi me thanë që mos me nxjerr kushte në dialog. Por tash kur të thotë presidenti yt, dhe kryeministri i vendit tjetër, i bie që veç ti po e pengon këtë proces. Kjo nuk është në rregull. Ne s'kemi ku me shku pa pas qëndrim të njëjta", - deklaroi Haradinaj.

mundësi e re dhe shumë e favorshme për ta shtruar çështjen e finalizimit të dialogut, në nivelin më të lartë të mundshëm. E kam mbështetur dhe e mbështes edhe sot taksën si një "klithëm" të Kosovës, që ta dëgjojë bota dhe si të tillë edhe e kam mbrojtur, kudo e më këdo. Po unë di që ajo është një taksë që i është vënë Serbisë, jo një

mur që i është vënë Gjermanisë, Francës apo SHBA, për t'i ndaluar ta ndihmojnë e ta mbështesin Kosovën, në rrugën e përpjekjes së mundimshme historike drejt një gjatë bota. Dhe kur këta aleatë të mëdhenj dhe të pazvëndësueshëm dot nga askush e askurrë (pa të cilët jo Ramushin, po as Kosovën

dhe të drejtën e saj njëqind vjet të mohuar s'do ta njihje kurrkush ende sot), kërkojnë thjesht pezullimin e përkohshëm të taksës, në mënyrë që të mund ta ndihmojnë e ta mbështesin Kosovën drejt një hapesë së saj të plotë ndërkombëtarisht, refuzimi është i pakonceptueshëm për mua. Shtoj këtu se më ka mbetur gozhde fakti që miqtë e mëdhenj, hasen në një refuzim të pashpjegueshëm edhe kur propozuan që përkundër pezullimit të përkohshëm të taksës, nëse në fund të muajve të dialogut nuk do të arrihej objektivi final i nënshkrimit të pages, atëherë do t'i hapje përfundimisht rrugë liberalizimit të vizave për Kosovën(!). Gjithsesi, meqë Ramushi u qa publikisht se unë i paskësua bërë më shumë presion se sa Vuçiqi për heqjen e taksës, mua s'më mbetet tjetër veçse të ngushëllohem me faktin që pas samitit edhe Vuçiqi, u shpreh publikisht ndaj meje po aq i palumtur sa Ramushi. S'kam dashur dhe s'dua të hyj asnjëherë në polemika publike me askënd në Kosovë, aq më pak me kryeministrin e Kosovës. Uroj që të mos jem i detyruar ta bej përsëri. Ai ka të drejtën e tij të flasë në emër të Kosovës, po mua s'ma heq dot askush të drejtën të flas për Kosovën.

GREQI - Një tjetër shqiptar është vrarë në burgjet greke. Mësohet se një 29-vjeçar ka humbur jetën mëngjesin e djeshëm pas një shërri mes disa të burgosurve në burgun e Trikalasë. Mediat greke kanë raportuar për vdekjen e një të riu nga Shqipëria, 29 vjeç. Kështu, "Pontos News" nënvizon se i riu shqiptar ka marrë plagë të shumta dhe u plagos rëndë, përpara se të dërgohej në spital, ku do të gjente vdekjen. Sipas drejtorit të spitalit Dimitris Parthenis, një raport mjekësor do të japë edhe arsyet e vdekjes së shqiptarit. "Trikalavoicë" shkroi se shqiptari nuk ka vdekur menjëherë në burg, por ishte transportuar edhe në spital. Ndërkaq, media greke e fokusuar më së shumti në ngjarje të kronikës së zezë "Zougla" raporton se shqiptari është godi-

Mediat: I riu u godit me thika në gjoks nga 2 rusë

Burgjet greke kthehen në kasaphanë për shqiptarët, masakrohet 29-vjeçari në Trikala

REAGIMI I BERISHËS

Ish-kryeministri i vendit, Sali Berisha përmes një statusi në "Facebook" ka reaguar pas vrasjes së një të riu shqiptar në burgjet greke. Berisha shprehet se burgjet greke po kthehen në një kasaphanë për shqiptarët, kurse iu bën thirrje autoriteteve ndërkombëtare për të inspektuar situatën në burgjet e vendit fqinj.

tur me thika në gjoks e në këmbë. Sipas "Zougla"-s, shqiptari i plagosur rëndë është nisur menjëherë për në spital me ambulancë. Plagët që ka marrë ishin të shumta dhe për rrjedhojë ka ndërruar jetë. Ajo që dihet është se lëndimet që ka marrë në trup

kanë qenë në kufijtë e horrorit. Gazeta tjetër helene "Tribune" shkruan se shqiptari, 29 vjeç, u plagos me thika në gjoks e trup, pas një tjetër përlëshjeje të egër me të burgosurve të Trikalës. Kjo media thotë se agresorët janë dy të burgosur rusë. "Autorët

e therën atë në gjoks, këmbë dhe brinjë", thuhet në artikull. Ky është incidenti i dytë i përgjakshëm midis të burgosurve në burgjet e Trikalës në 20 ditët e fundit. Më 12 prill, një 55-vjeçar i burgosur shqiptar sulmoi dhe vrau një 66-vjeçar. Shifrat dhe raportimet mediatike janë një tregues i qartë i situatës së rëndë që po ndodh me shqiptarët në burgjet greke. Në harkun kohor të 1 viti janë regjistruar 6 shqiptarë të vrarë në burgjet e Greqisë. Dhe këtu nuk janë llogaritur të burgosurit shqiptarë, që kanë kryer vetvrasje apo raste kur vdeket kanë qenë të dyshimta.

VRASJET E SHQIPTARËVE

- **1 maj 2019** - Një 29-vjeçar shqiptar vritet në burgun e Trikalasë. Gjatë një përlëshjeje, dy të burgosur me origjinë ruse e qëlluan me thika të improvizuara në gjoks dhe në këmbë.
- **27 janar 2019** - Në burgun e Koridhalos vritet Bardhyl Tusha, i njohur edhe me emrin Bandoli Tusha. Ai u gjet i pajetë në qeli dhe fillimisht u dyshua se kishte humbur jetën nga përdorimi i mbidozës. Por ekspertiza mjeko-ligjore doli në konkluzion se Bardhyl Tusha ishte mbetur në qel.
- **14 janar 2019** - Arbër Bako vritet në burgun e Koridhalos. Vrasja e tij është filmuar nga kamerat e sigurisë në korridoret e burgut, ku duken dy persona që e godasin vazhdimisht me thika të improvizuara, teksa Bako përpiqej t'u largohej. Ai u dërgua në spital, por nuk mbijetoi.
- **27 dhjetor 2018** - Gëzim Shekaj 33 vjeç nga Vlora gjendet i vrarë në qelinë e spitalit psikiatrik të burgut të Koridhalos. Një i afërm i tij tha se 33-vjeçari i ishin injektuar gjilpëra.
- **25 nëntor 2018** - Një 35-vjeçar shqiptar u gjet i vrarë në qelinë e tij në burgun e Trikalasë. Shkaqet janë mister.
- **8 shtator 2018** - Në burgun e Koridhalos vritet shqiptari Franc I. 31 vjeç.
- **Më 27 mars 2014** në burgun e Malandrinos u vra Kudret Kume apo Ilia Kareli, i cili ishte viktimë e një torture çnjerëzore nga gardianët.

Kryesindikalisti Konstandin Kina: Projektligji i përgatitur është i mangët

BERAT

Përfaqësues të Sindikatës së Naftëtarëve dhe përfaqësues të ndërmarrjeve të naftës nga i gjithë vendi u mbledhën dje në qytetin naftëtar të Kuçovës, ku kanë firmosur një peticion drejtuar kryeministrit Edi Rama me kërkesat e tyre. Në emër të naftëtarëve shqiptarë, një prej kategorive më të vuajtura të popullsisë sonë, shumica e të cilëve me sëmundje profesionale e që vdesin për shkak të kushteve të vështira të punës në industrinë e naftës, përfaqësuesit e sindikatës parashtruan problematikat që prekin këtë kategori, duke deklaruar nevojën emergjente për të sjellë një drejtësi për trajtimin e duhur financiar të kategorive të vështira në Shqipëri, siç janë: naftëtarët, minatorët, metalurgët etj. Naftëtarët kanë kërkuar nga qeveria të mbajë qëndrim përgjegjës në lidhje me nismën që u ndër mor për përgatitjen e projektligjit për trajtimin financiar shtesë të profesioneve të vështira. Pas diskutimeve të shumta për padrejtësitë e mëdha dhe indiferencën vrasëse të shtetit ndaj naftëtarëve në të kaluarën, ata i kërkuar qeverisë korrëgjimin e ligjit të statusit të naftëtarëve, duke mbajtur premtimin e dakordësuar më 26 prill 2018, për një shtesë financiare dinjitoze 40% të pagës minimale si rritje të pensionit aktual. Në fund të takimit, të gjithë naftëtarët e pranishëm firmosën peticionin drejtuar kryeministrit Rama me kërkesat e tyre, peticion që do të përcillet për t'u firmosur nga të gjithë naftëtarët në çdo ndërmarrje të prodhimit të naftës në vendin tonë. Bura e gra naftëtarë kanë folur për kushtet e vështira në punë, problemet shëndetësore që kanë prej vitësh dhe indiferencën e shtetit

Statusi i naftëtarit, sindikata peticion Ramës: Duam shtesë 40% të pagës minimale

"Qeveria të mbajë premtimin dhe për rritjen e pensionit aktual"



Takimi i djeshëm në Berat



ndaj trajtimit të tyre të padrejtë financiar. Kryetari i Sindikatës së Re të Naftëtarëve të Shqipërisë, z.Konstandin Kina u shpreh se qeveria duhet të amendojë Ligjin aktual për statusin e Naftëtarit Nr.8/2017 dhe ti japë kësaj kategorije të drejtat e munguara prej vitësh. Kina ka deklaruar se projektligji i përgatitur është i mangët, pasi nuk përfshin dakordësinë e shprehur me Ministrinë së Energjetikës e Infrastrukturas dhe Ministrinë së Financave, që trajtimi financiar shtesë i pensioneve nga profesionet e vështira të ishte 40% e pagës minimale, pra 10 mijë lekë në muaj. Sipas Kinës, trajtimi aktual financiar i naftëtarëve është një tallje për naftëtarët dhe një padrejtësi shumëvjeçare. Kina ka po-

huar se qeveria duhet të përcaktojë afatin kohor të përfitimit të statusit 15-vjet për meshkujt dhe 10-vjet për gratë. Gjithashtu, ai tha se nëse kërkesat e naftëtarëve nuk merren parasysh ata do të përshkallëzojnë formën e rebelimit duke bllokuar prodhimin.

KËRCËNIMI

Sipas kryesindikalistit Kina, trajtimi aktual financiar i naftëtarëve është një tallje për naftëtarët dhe një padrejtësi shumëvjeçare. Kina ka pohuar se qeveria duhet të përcaktojë afatin kohor të përfitimit të statusit 15-vjet për meshkujt dhe 10-vjet për gratë. Gjithashtu, ai tha se nëse kërkesat e naftëtarëve nuk merren parasysh, ata do të përshkallëzojnë formën e rebelimit duke bllokuar prodhimin.

FIER - Për pak sa nuk ka përfunduar në vrasje një sherr banal dje në Fier, ndërsa një 66-vjeçar është arrestuar në flagrancë nga policia për tentativë vrasje. Sipas bluve, shtetasi Gani Kasëmi ka qëlluar me thikë në kokë një 57-vjeçar, pas një shërri të çastit mes tyre. Dyshohet se autori i ka qenë në gjend-

Masakron me thikë 57-vjeçarin, përfundon në pranga i moshuari

je të dehur në momentin kur ka qëlluar me thikë 57-vjeçarin, të cilit i ka shkakuar dëmtime në kokë dhe ndodhet në Spitalin Rajonal Fier nën kujdesin e mjekëve. "Pas ngjarjes, specialistët për

Hetimin e Krimeve në Komisarariat dhe Policisë Fier arrestuan në flagrancë shtetasin Gani Kasëmi, banues në Fier për veprën penale "Vrasje e mbetur në tentativë", njoftoi policia.

Shpërndanin heroinë dhe kanabis sativa, kapen dy persona

TIRANË - Dy persona kanë rënë në prangat e policisë për shpërndarje të lëndëve narkotike në kryeqytet. Mësohet se shtetasve me iniciale A.D.30 vjeç dhe K.C. 21 vjeç u janë gjetur 5 doza me lëndë të dyshuar të llojit kanabis. Sipas burimeve policore, të riut A.D., banues në Tiranë, gjatë kontrollit fizik të tij në momentin e kapjes në flagrancë si dhe gjatë kontrollit të banesës, iu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale: 18.2 gr lëndë e dyshuar narkotike heroinë. I peshorë elektronik dhe 1 celular. Ndërsa, 21-vjeçarit K.C., banues në Tiranë, gjatë kontrollit të ushtruar në ambientet e një lokali shërbimit e policisë i kanë gjetur 5 doza me lëndë të dyshuar narkotike të llojit kanabis, të cilat u sekuestruan me cilësinë e provës materiale. Vazhdojnë hetimet për identifikimin e personave të tjerë të përfshirë në këtë aktivitet kriminal. Materialet procedurale në ngarkim të këtyre shtetasve të arrestuar i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës Parë Tiranë për veprën penale: "Prodhimi dhe shitja e lëndëve narkotike".

TIRANË - Pas afro një muaj pas grabitjes spektakolare në aeroportin e Rinasit, është konfirmuar shumë e saktë e parave që u morën në barkun e avionit që kishin si destinacion Vjenën. Behet fjalë për shumën prej 6 milionë eurosh, e cila konfirmohet nga 3 bankat e nivelit të dytë në deklaratat e tyre për Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Fillimisht u aludua se ishin 10 milionë euro të grabitura. Pak minuta



Grabitja spektakolare në aeroportin e Rinasit, bankat: Autorët morën shumën prej 6 mln eurosh

pas grabitjes, gjatë një shkëmbimi zjarri me policinë mbeti i vrarë me plumb në kokë Admir Murataj. Ndërkohë, nga policia janë arrestuar gjashtë persona të dyshuar: Oltion Veseli, Alkond Bengasi, Renaldo Sula, Elton Pikli, Saimir Cela dhe shtetasi nga Kosova, Ragip Hajdini. Alkond Bengasi është bërë dëshmitar i

drejtësisë dhe ka dhënë dëshmi që i shërbejnë zbardhjes së supergrabitjes. Dy ditë më parë Gjykata për Krime të Rënda vendosi masën e sigurisë "Arrest me burg" ndaj 50-vjeçarit Hajdini nga Peja. Gjatë seancës gjyqësore, ai deklaroi se nuk është i përfshirë në grabitje, ndërsa kërkoi që të përballet me Bengasin. "Kam njohje me

familjen Murataj. Isha në varrimin e Muratajt, kam njohje me vëllain e tij, Aleksandrin (ndodhet në burg). Por nuk jam unë 'Daja' që kërkoni", u shpreh ndër të tjera Hajdini. Ndërsa, janë ende në kërkim shtetasit Talo Çela, Klement Çela, Eldi Çela, Marenglen Hoxha, ish-punonjës policie; Aleks Pepa dhe një tjetër.

Ngjarja e 30 janarit në Selitë dyshohet të ketë si motiv hakmarrjen



TIRANË

Ekzekutimi me 10 plumba i ish-efektivit të policisë Arben Bilali, prangoset një i dyshuar

47-vjeçari Arben Tirana dyshohet se u ka siguruar mjetin tip "Benz" autorëve të vrasjes

Tre muaj pas vrasjes në Selitë të ish-efektivit të policisë Arben Bilali, policia ka vënë në pranga një person, i cili dyshohet se ka dijeni për ngjarjen e rëndë që tronditi kryeqytetin. Behet fjalë për 47-vjeçarin Arben Tirana (Xhetani), banues në Shkozë. Tirana është ndaluar me urdhër të Prokurorisë së Tiranës, pasi akuzohet për veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës. Mësohet se ai njihet si person me precedentë të mëparshëm penalë, kryesisht në fushën e vjedhjes së automjeteve. Sipas burimeve nga policia, ai dyshohet se u ka siguruar mjetin tip "Benz" autorëve të vrasjes, i cili u gjet vetëm pak minuta më vonë i braktisur në Mjull Bathore, çka do të thotë se është takuar dhe i ka parë autorët. "Në vijim të veprimeve për zbardhjen, dokumentimin dhe arrestimin e autorëve të vrasjes së shtetasit A.B., në bazë të urdhrorit ndalimit të lëshuar nga prokurori, u bë kapja dhe ndalimi i shtetasit në kërkim A.T (Xh). 47 vjeç, banues në Shkozë, Tiranë, i dyshuar për kryerjen e veprës penale 'Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës'. Vijon puna hetimore për zbardhjen e plotë të ngjarjes", bëri dije me dije policia.

NGJARJA

Ish-policia Arben Bilali u ekzekutua pranë shtëpisë së tij me 10 plumba, ndërsa familja e tij ishte në konflikt dhe e ngjuar: 50-vjeçari kishin dalë nga banesa disa orë para se ta qëllonin. Ai po kthehej në shtëpi me një makinë tip "Golf 4", ku po udhëtonte si pasagjer. Makina e tij është vënë në ndjekje nga dy atentatorët që udhëtonin me një "Benz" të zi. Pas verifikimit të kamerave të sigurisë, rezultoi se Bilali u ndoq për rreth 9 km që prej kryqëzimit të "Vasil Shantos" deri në rrugën "Danieli Ndëreka", ku kishin shtëpinë. Rruga drejt banesës së Bilalit është njëkalimshme, çka iu ka mundësuar atentatorëve ta ndjekin viktimën pa rënë në sy. Rreth 50 metra larg shtëpisë së tij, mjeti tip "Golf 4", i drejtuar nga djali i një shoku të Arbenit ndaloi që



Ish-policia Arben Bilali

ky i fundit të zbriste. Teksa makina u drejtua në rrugën dytësore të autostradës Tiranë-Elbasan, një prej personave që ndodhej në mjetin tip "Benz" dhe dyshohet se është vrasës me pagesë, ka hapur zjarr nga një distancë prej rreth 5 metrash drejt Arben Bilalit. Burime pranë policisë thanë se vrasja është

të kryer me një armë automatike me silenciator dhe drejt viktimës është qëlluar rreth 15 herë nga brenda makinës në ecje. Po të njëjtat burime pohuan se dyshohet që atentatorët e kanë mbajtur prej kohësh nën vëzhgim 50-vjeçarin, duke ndjekur lëvizjet e tij, për të arritur në eliminimin e tij fizik. Në



Vendi ku ndodhi vrasja

lidhje me ngjarjen në fjalë janë shoqëruar dhe marrë në pyetje dhjetëra persona të dyshuar. Ndërsa, dyshohet se atentatorët janë vrasës me pagesë. 50-vjeçari është djali i tretë i familjes Bilali, që është vrarë për shkak të një përplasjeje me një grup të njohur në zonë. Ish-policit i kanë vrarë dy vëllezërit Bujar dhe

Leonard Bilali. Bujar Bilali është vrarë në vitin 1998, ndërsa Leonard, ish-mundës i Dinamos në gusht të 2010-ës, në të njëjtin vend ku u vra tre muaj më parë ish-policia. Policia po heton në disa pista për zbardhjen e kësaj ngjarjeje, ndërsa nuk përjashtohet pista e hakmarrjes.

KUSH ËSHTË VIKTIMA

Arben Bilali, ka qenë punonjës policie te komisariati nr.2 si dhe efektiv i Repartit të Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH) në Tiranë, detyra nga të cilat është larguar disa vite më parë. 50-vjeçari është vëllai i tretë në familjen Bilali, që ekzekutohet në atentat. Viktima e parë në këtë familje ishte Bujar Bilali, i cili u vra në një atentat në vitin 1997. Ndërsa, vëllai më i vogël, Leonard Bilali (ish-mundës i Dinamos) u ekzekutua më 10 gusht të vitit 2010. Vetëm pak muaj para vrasjes së këtij të fundit, Arben Bilali mbeti i plagosur, por i mbijetoi atentatit.

Sekuestrohen 204 kg marijuanë me destinacion Malin e Zi, një në pranga e një në kërkim

SHKODËR - Një sasi e konsiderueshme droge me destinacion Malin e Zi u sekuestrua dhe nga policia në fshatin Vrakë të Malësisë së Madhe. Mësohet se gjatë operacionit të koduar "Liçeni" u arrestua në flagrancë 33-vjeçari Marjan Kurteza, banues në fshatin Shtoj i Ri si dhe u shpall në kërkim 35-vjeçari D.B.,

banues në Shkodër. "Në bazë të informacioneve policore dhe punës operative policore të bërë në lidhje me një grup kriminal që kryenin organizimin, financimin, transportin dhe trafikimin e lëndëve narkotike (marijuanë) nga qyteti i Shkodrës në drejtim të Malit të Zi, në orët e para të mëngjesit të sotëm është marrë informacion se dy shtetas po tento-

nin të trafikonin një sasi të konsiderueshme lëndë narkotike. Mbi bazën e këtyre informacioneve është zhvilluar operacioni i koduar "Liçeni". Si rezultat, në breg të liqenit Shkodër u bë kapja në flagrancë e shtetasit M.K. si dhe u shpall në kërkim D.B.", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Ndërkaq, mësohet se gjatë operacionit në fjalë u



sekuestruan cilësinë e provës materiale 204 kg marijuanë, 2 mjete një tip "Land Rover" dhe një mjet tip "Mercedes Benz", 4 telefo-

na celulare, si dhe mjete që i përdornin për paketimin e lëndës narkotike. Policia pohoi se operacioni vijon për kapjen e shtetasit D.B.. Grupi hetimor nën drejtimin e prokurorisë vijon hetimet për identifikimin dhe kapjen e bashkëpunëtorëve të tjerë në këtë aktivitet kriminal. Materialet procedurale i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, pasi dyshohet për veprat penale të "Trafikimit të narkotikëve" kryer në bashkëpunim e mbetur në tentativë" dhe "Prodhimit e shitjes së narkotikëve kryer në bashkëpunim".

NDERTIMET PA LEJE TAPITE

Agjencia Shtetërore e Kadastrës do të regjistrojë pronat e pajisua me leje legalizimi

Tapi për 480 personat që kanë ndërtuar pa leje në qarkun Vlorë

Lista me përfituesit e certifikatave të pronësisë

Publikohet listën me 480 persona që kanë përfituar lejen e legalizimit dhe tashmë prona e tyre do të regjistrohet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për t'u pajisur me certifikatën e pronësisë. Përfituesit janë në qarkun e Vlorës. Ndërkohë në të gjithë vendin janë 80 mijë leje legalizimi të dhëna nga Agjencia e Legalizimeve ndër vite, që nuk janë regjistruar në sistemin e hipotekës. Me krijimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, këto leje të dhëna, por të paregjistruara do të kalojnë në një pjesë të veçantë të sistemit, për të mos kufizuar qytetarët nga e drejta e tyre mbi pronësinë.

SIPËRFAQET

Sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funksion banimi, jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim, i shiten poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin, nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese



mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kryhet: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirisht dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjektet mund të përcaktojnë përveç pjesës takuese, edhe pjesët fizike respektive, nëse ndërmjet tyre përputhet vullneti.

AGJENCIA

Agjencisë Shtetërore të Kadastrës është institucioni shtetëror përgjegjës për administrimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme, si dhe për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë (ligjërimi i ndërtimeve pa leje, proceset e lidhura me tokën bujqësore, trajtimin e pronës dhe inventarizimin e pronave shtetërore) të trajtuara me ligj të posaçëm.

Ligji i ri për kadastrën synon të përmirësojë kuadrin ligjor për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, duke parashikuar norma të reja ligjore për mënyrën e administrimit të regjistrit publik të këtyre pasurive, pasqyrimin e të drejtave dhe detyrimeve që rëndojnë mbi pasuritë e paluajtshme, si dhe përmirësim-përditësimin e të dhënave të regjistrit për të korrigjuar pasak-

LEGALIZIMET

Në të gjithë vendin janë 80 mijë leje legalizimi të dhëna nga Agjencia e Legalizimeve ndër vite, që nuk janë regjistruar në sistemin e hipotekës. Me krijimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, këto leje të dhëna, por të paregjistruara do të kalojnë në një pjesë të veçantë të sistemit, për të mos kufizuar qytetarët nga e drejta e tyre mbi pronësinë.

kadastrës ka Drejtorinë e Përgjithshme në Tiranë dhe drejtori e zyra varësisë në nivel vendor, teksa organizimi dhe numri i strukturave të varësisë përcaktohen nga kryeministri me propozim të Këshillit Drejtues. Organet drejtuese të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës janë Këshilli Drejtues dhe drejtori i përgjithshëm, i cili është njëkohësisht edhe anëtar i Këshillit Drejtues. Këshilli Drejtues do të ketë gjithsej 7 anëtarë. Anëtarët duhet të kenë formim profesional të fushave të inxhinierisë, gjeodezisë, drejtësisë, ekonomisë, ose administrimit publik, si dhe përvojë pune të paktën 5 vjet në organet e administratës shtetërore. Anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues nuk janë funksionarë me kohë të plotë dhe zgjidhen përkatësisht si përfaqësues nga: a) Ministri i Drejtësisë, b) Ministri i Financave, c) Ministri përgjegjës për bujqësinë, ç) Ministri përgjegjës për zhvillimin urban, d) Kabineti i kryeministrit, dh) Autoriteti shtetëror përgjegjës për informacionin gjeohapësinor.

PERSONAT QË KANË NDËRTUAR PA LEJE

ABAS QERIM HADERAJ
ADEM HETEM RUKAJ
ADHURIM RAMADAN PETANAJ
ADRIAN FETI VELAJ
AGIM BRAHIM SINAJ
AGIM SAMI JAHAJ
AJET NEBI ZENUNAJ
AJET SEIT FILAJ
ALBAN PIRO ALIAJ
ALBERT QATIP HASANALIAJ
ALBIN PULLUMB KHANAJ
ALEKSANDER HARIS HARIZAJ
ALEKSANDER ZENJEL
SULEJMANI
ALFRED KUJTIM RAPAJ
ALFRED TARE ALLIAJ
ALI LAVDOSH BULLA
ALTIN CANE SELA
ALTIN HODO LAMAJ
ALTIN RAHMI DORACI
ALTINO RAMIS BULLA

ALUSH MIFTAR KOÇERRI
ANDON ISMET XHAFERI
ANDREA KITO PETRAJ
ANDREA LIU ZIU
ANESTI KOLA QIRJO
ANETA NASI ILIA
ARANIT AGRON SADIKAJ
ARANIT GJYSHO HALILAJ
ARBEN BILBIL HODAJ
ARBEN KADRI BREGAJ
ARBEN LLAZAR PIPERI
ARDIAN NEBI ZENUNAJ
ARGJINANR BARJAM IMAMAJ
ARITUSHA ALEKS NASAJ
ARTAN HAKIM ISARAJ
ARTAN HAMZA BREGAJ
ARTAN TAHIR BIXHAJ
ARTUR GANI VELAJ
ASQERI AGUSH XHELAJ
ASQERI REFAT ARAPI
ASTRIT ALUSH SEJDIRAJ

ASTRIT GODO QEJVANI
ASTRIT GODO QEJVANI
ASTRIT ILMI BIMO
ASTRIT MAMAN LAMAJ
AVDULLA RESMI HASANAJ
AZEM DEMIR ZYKAJ
BARDHOSH DURIM TOZAJ
BARDHOSH REXHEP BEGAJ
BARDHYL QANI HAXHIRAJ
BASHKIM KASO RUCI
BEDRI AGUSH HOXHAJ
BEJKO FUAT HODAJ
BEJKO FUAT HODAJ
BEKIM LIK FEGAJ
BELUL BRAHUSH FENERAJ
BENI FAIK SULÇE
BEQIR REXHEP ARAPI
BEQIR SULJEMAN TROKA
BESHIR KOJDEL XHELAJ
BESIM CIZE CANAJ
BESIM DEMIR ZYKAJ

BESIM SABRI MEMA
BESNIK BARJAM BARJAMAJ
BESNIK RAZIP SKENDERAJ
BLEDAR ASQERI ARAPI
BLEDAR ROBERT SINAJ
BUJAR KUJTIM ZYKAJ
BUJAR QEREM HAMETAJ
CANE DEMIR TROKA
ÇERÇIZ MALO MALAJ
DAFINA DEMIR HADERAJ
DEJVI DASHAMIR HAZIZAJ
DHOKSI DHORI SULOVARI
DHORI DHIMO SEFERAJ
DILAVER HALIL HODAJ
DILAVER SINAN SINAJ
DINO RREMZIJ ALUSHAJ
DURIM BRAHIM TOZAJ
DURO BARJAM KAPAJ
EDMOND LIG FEGAJ
EDMOND KUJTIM PETOSHATI
EDMOND QERIM BULLA

EDUART FADIL XHINDI
EDUART MUHAMET AVDULI
EKTOR MYSLIM HOXHAJ
ELEONARDO NOVURUS JAHAJ
ELIDJON SHKELQIM CANAJ
ELIONA HAZBI HAZIZAJ
ELTON BESNIK TORRAJ
ENGJELLUSH HAXHI ISLAMAJ
ENGJELLUSH SELAMET
HOXHAJ
ENO RAMIS BULLA
EQEREM AJREDIN DINE
ERIND SHAIPI TROKA
ERION GODO MEZURI
ERMAL MEDIN MENAJ
ERMAN LAMO BARJAMI
ERVIN MEHMET HAZIZAJ
ERVIN XHELAL HOXHAJ
FANI KICO BOMBAJ
FASLI AZEM HOXHAJ
FATMIR NOVURUS AZIZI

| | | | | |
|------------------------|-------------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|
| FATMIR QAZIM SULAJ | LEVZAT LUAN SHAHAJ | RRUFE ISMAIL YMERAJ | NIMET SHYQYRI ALLIAJ | SINAN MYDEI ALIAJ |
| FATUSHE XHAFFER DORACI | LLAQI JOTI KOMANAKU | RUSHIT PELIVAN BEQIRAJ | NOVRUS MUSA BARJAMAJ | SKENDER HAMET ABAZI |
| FEHIM DALAN DANAJ | LLAZAR KOZMA SEFERAJ | RÜZHDI YMER CAUSHAJ | NOVRUS MUSA BARJAMAJ | SKENDER SADIK AGAJ |
| FERDINANT SALO HOXHAJ | LLAZI TOLI MIHALAJ | SABAUDIN RUSTEM ALINIKAJ | NURIE MYFTAR DAUTI | SOFIE SHEFQET OSMANLLARI |
| FESTIM BARJAM XHELAIJ | LUAN RRAPO ALUSHAJ | SADIK KUJTIM ZYKAJ | OLJAN FADIL BASHLLARI | SOKOL REXHEP ÇAMER |
| FESTIM DINO ALUSHAJ | LUFTIM DURIM TOZAJ | SADIK LAVER BULLA | OSMEN MEZAN ADEMI | SOKOL ZYLFO |
| FIODOR HAZBI SHAMETAJ | LULEZIM AGUSH XHELAIJ | SAJMIR SALI TOJA | PANAJOT HAMZA NEBIU | SOKRAT RESUL DANAJ |
| FITIM SHAIPI KOÇIAJ | LULEZIM FERIK KANAJ | SEFEDIN BEQIR BULLA | PANAJOT HAMZA NEBIU | SOTIR HADER LAZAJ |
| GANI SELIM DANAJ | LULEZIM LEFTER GEGAJ | SEFER DULE ISARAJ | PANDELI HARE DIN GAÇAJ | SPIRO LUFTAR ZHUPAJ |
| GAQI ISMET KAMBERI | LUTFI SELIM SELIMI | SERRI XHEMIL HOXHA | PASKAL KASEM MALAJ | STOLI MEHMET MUÇO |
| GAZMIR ABAS DORACI | LUTO MEDIN XHELILAJ | SHEFIT GJOLEK XHELAIJ | PELLUMB ALI BRAHIMI | SULO ÇOBAN LLAÇAJ |
| GAZMIR HASAN SINAJ | MANOL NASI MITRAJ | SHKELQIM KUJTIM PESHTANI | PELLUMB FECORR SAKO | SYRJA DERSH VISH ZOTAJ |
| GENCI HAIR SELIMAJ | MARIGLEN BASHKIM FEGAJ | SHPENDI MURAT SKENDERAJ | PELLUMB IMER METAJ | TAHIR AVDULLA RYSTEM |
| GEZIM ALI XHUPI | MARINA RRAPO BUCAJ | SKENDER SELMAN SHERAJ | PELLUMB MEMET METAJ | TAJAR SHYQYRI MATAJ |
| GEZIM MITAT GJIKAJ | MARKO NAQI PETRAJ | SKENDO HAKI LAMAJ | PELLUMB MUSA OMERI | TAULANT SHKELQIM |
| GEZIM RAMADAN NAZAJ | MEHMET XHEMIL HAZIZAJ | SOFO JAUP DEMAJ | PELUMB SALI SHAHAJ | BEJDOLLARI |
| GJOLEK RREMZI HODAJ | MEMIN NURI HOXHAJ | SOFO SULEJMAN ZAHAJ | PERPARIM LAVER HOXHA | TEFERI HALIL HALLA |
| GJOLEK RREMZI HODAJ | METUSH RAMIS LAMAJ | SOKOL ADHURIM IDRIZAJ | PERPARIM PAJTIM HOXHAJ | TELHA HASAN HALILAJ |
| GRAMOZ GANI VELAJ | MIHAL KOCI BOMBAJ | SOKOL MITAT GJIKAJ | PETRAQ JORGO PETRAJ | THANAS GODO BALILI |
| GRANIT DAUT SELA | MIHO LEKSI SHOLLAJ | SOKRAT ALUSH SEJDIRAJ | PETREF MYSTEHAK HOXHAJ | THOMA BENDO LIÇI |
| HAIRI AQIF ISMAILI | MUHAMET HAMIT GJIKONDAJ | SOKRAT DHIMO SEFERAJ | PETRIT MITAT JAKUPI | TODI DHIMITER ÇUNI |
| HAKIM AZEM DINUSHI | MUHAMET HARUN ZENELAJ | SOKRAT NASI MITRAJ | PETRIT XHEVDET RUKAJ | TOMOR LEFTER IMERI |
| HAMIT QEMAL HOXHAJ | MUISI JAUP AZIZAJ | SOKRAT PASKAL QIRJO | PETRO FATOSH ALIRAJ | TRITAN AVNI KURTI |
| HASAN AZBI SINAJ | NDRICIM SHKELQIM CANAJ | SOTIR KOL PAPA | PIRO MUIM MAHILAJ | TRITAN MURAT RRAPAJ |
| HASAN KUJTIM HARIZAJ | NEKI IZET DANAJ | SPIRO ADEM FEGAJ | PRENJO PAJTIM OSMENAJ | URMA HALIL ÇELAJ |
| HAXHI FERIK KOLLOVI | NELO RAMIS LAMAJ | SPIRO DAUT SELA | QAMIL RAMADAN COLLARI | VALTER QAZIM NAZUFI |
| HAXHI ISMET SULAJ | NERITAN PIRO JAUPAJ | SULEJMAN KUJTIM PESHTANI | QEFSERE SIHAT XORXI | VANGJEL ANASTAS PANGO |
| HEKTOR NAMIK LLANAJ | NERTIL NEXHIP VELO | TAHIR RAMADAN BULLA | QEMAL ADIF RRAPAJ | VANGJEL LLAZI DEGA |
| HEKURAN TAFIL RIBAJ | NEVREZ HYSENJ MURA | TAULANT GRAMOZ BIMAJ | QEMAL LIK MUSTAFA | VANGJEL THANAS BAKA |
| HIDAI LILO LAMAJ | NEXHAT HAIR NUREDINAJ | THANAS HYSNI PETRAJ | QENDRO MEDIN BITAJ | VASILLAQ GJERGJI NAKA |
| IDAJET QEMAL QEMALI | NIMET PANDELI DAPAJ | TODI ARQILEA NASAJ | RABIJE MEHMET SULEJMANAJ | VELI PASHO RESULAJ |
| ILIA VANGJEL PETRAJ | NURI HARUN HARIZAJ | TODI ARQILEA NASAJ | RAKIP HAMDË XHELAIJ | VELI PASHO RESULAJ |
| ILIR DURIM TOZAJ | OLLGA JORGJI PETRAJ | TODI KOLA JASO | RAMADAN NEKI NUREDINAJ | VESEL SHABAN SHABANAJ |
| ILIR MYFTAR FEJZEJ | OSMEN ISMET SULAJ | TODI LLAZI GJONCARI | RAMADAN SALI KOLLAÇAKU | VESEL TARE MALUSHI |
| ILIRJAN HASAN BASHO | OSMEN SHASK KAPAJ | TOMOR ELHAM SADEDINAJ | RASIM MUSTAFA TOSKA | VEZIR PELIVAN VESHAIJ |
| ISA RESUL BALILAJ | PANAJOT ARSHI HAXHIRAJ | TRIM RAKO SHAMETAJ | REFAT MUSTAFA XHULAJ | VIOLETA MYFTAR HOXHAJ |
| ISMAIL HALIL QEQVANI | PANDELI CONI BOMBAJ | VASIL LLAMBRO DANI | RESHAT DANO DEMIRI | VIRJON DERSH VISH MUSKAJ |
| ISMAIL YZEIR KEQAJ | PANOZAQ GODO MEZURI | VASIL LLAMBRO DANI | REUF SAMI HAXHIRAJ | VIRON HAKI BEQIRI |
| ISUF AHMET ALIAJ | PASHO MAZE FILAJ | VELIDE RIZA BULLA | RUBIE REXHO RROKAJ | VITURI NURÇE BREGASI |
| IZMIR AGRON SKENDERAJ | PASKAL LEÇI BOMBAJ | VELINA MEZIN PASHAJ | RUBIJE DALIP HAMZO | VJOLA EQEREM XHAFAJ |
| JANI LIO ZIU | PATRIOT SADIK NURAJ | VENDIGJAR GURI HODAJ | RUDINA HABIB HYSENI | VLADIMIR BEKHET BEGAJ |
| JANI RAPO THANASI | PAZAIT HASIM MURATAJ | VENETIKE XHEMAL HADERAJ | RUSHIT QAZIM BEGO | VLADIMIR RAMADAN ÇAKA |
| JAUP SINAN DEMAJ | PELIVAN ABEDIN TAIPË | VERE SEFEDIN MALAJ | RUSTEM XHEMAL KOSOVA | VLADIMIR TELO BEJTAJ |
| JORGJI BANI XHOGU | PELLUMB XHELADIN LAMAJ | VEXHI HARIS MEZURAJ | RÜZHDI MEDIN XHELILAJ | VOJO JAZO DAVACAJ |
| JULI RAMIS BULLA | PERLLAT NAMIK HAXHIRAJ | VEXHI ISNI TORRAJ | SABIRE OSMEN KANANAJ | VULLNET LUTO HARIZI |
| KADRI MURAT BUZA | PERPARIM HAIR SELIMAJ | VIKTOR ADEM ADEMAJ | SADUSH NERQES ZEÇAJ | VULLNET SKENDER VELIKA |
| KADRI XHAFFER METE | PERPARIM HAKI LAMAJ | VIKTOR RAMADAN TOZAJ | SADUSH PETRIT TAPA | XHAFO TETEM LIKAJ |
| KAJO MAMAN LAMAJ | PETRIT BASTRI NUREDINAJ | XHAFFER DURIM TOZAJ | SAIMIR MURAT ALLA | XHEBRO HAKAN RRAPAJ |
| KAJO NAZIF PETANAJ | PETRIT BASTRI NUREDINAJ | XHELADIN JONUZ FILAJ | SALO ELHAM KANAJ | XHELAL ABEDIN HALILAJ |
| KANAN SELIM KANANAJ | PETRIT KANAN RUSTEMAJ | XHEVAIR NURI HARIZAJ | SAMI AXHEM GOXHA | XHELAL DULE ZEKAJ |
| KATE SHERO CAUSHAJ | PETRIT QEMIL RRAPAJ | XHEVAIRE QEMAL QEMALI | SAZAN HETEM KALOÇI | XHELAL MISIN LIKA |
| KLEAND AVDI ZENUANAJ | PETRIT SADIK REXHAJ | XHEZMI AJET SADIKAJ | SAZAN SULEJMAN RRAPAJ | XHELIL IDRIS CANALIAJ |
| KOMUNITETI ORTODOKS | PILO VANGJEL NASTASAJ | YLLI LAVDOSH BULLA | SEIT SINAN BISHAJ | XHELIL IDRIS CANALIAJ |
| KRENAR DEMIR ZYKAJ | PIRO NAMIK ÇEPAJ | YLLI METO ZANAJ | SEJDI BRESHAN ALIAJ | XHEMIL BARJAM FEJZO |
| KRENAR HODO LAMAJ | POLIGRON GJYSHO HOXHAJ | YMERLI SEIT FENERAJ | SELAMI PERLLAT RUNA | XHEVAIR JAÇE SADIKLLARI |
| KRENAR RAZIP SKENDERAJ | PUSHIME BAXHUL LELAJ | YQMET SALI KAPAJ | SELIM REFAT PASHAJ | XHEVDET KASEM HOXHAJ |
| KSANTHIPI NASHO RRAPAJ | QAZIM BEQIR BULLA | ZENEL AGO HOXHAJ | SERVET SHEFQET DOKU | XHIKO CANO VESHAIJ |
| KUJTIM SHAQO VALLAJ | QEMAL MYQEREM HAXHIRAJ | ZIJA RUSTEM ZEKAJ | SHAIP HASAN KOÇIAJ | XHULIETA SELAM XHAFFERI |
| KUJTIM TEZIK BREGU | QERIM VELI BREGU | ZILIDE TAFIL BOCAJ | SHKELQIM CUMAN MATAJ | YLLI BEQIR BARI |
| KUNDRET SELIM SELIMI | QIRJO TUNI RRAPAJ | ZOI KOZMA BOMBAJ | SHKELQIM QAMIL ÇELA | YLLI ISTREF ÇELAJ |
| LADIMIR RESUL SHAHAJ | RAMADAN KADRI GJATAJ | NAILE SULO LARA | SHKELQIM RIZA SINANAJ | YZEIR NEKI ASLLANAJ |
| LANDI HEKTOR HOXHAJ | RAMADAN MYRTE SADIKAJ | NAZMI JAKUP ALIU | SHKELQIM VEIP RROKAJ | ZAIM REFAT NUKAJ |
| LAVDI EKURAN TROKA | RAPO SELMAN DANAJ | NECO NIKO BOLLANO/ | SHKELZEN FATOSH COBO | ZAIM TAJAR MUSAGALLIU |
| LAVDIM XHEBRO KASAJ | RAZI ALI BINJAKAJ | NECO NIKO BOLLANO/ | SHPETIM DALAN SINOVARFAJ | ZELO SHYQYRI MERKO |
| LAVDOSH MEHMET DALIPAJ | RAZIP GODO MEZURI | NECO NIKO BOLLANO/ | SHPETIM ISMAIL SEFREJ | ZENEL BEJO BEDINAJ |
| LAVDOSH METUSH LILAJ | REIS ADEM BULLA | NECO NIKO BOLLANO/ | SHPRESA PAJTIM BELLO | ZENEL TAFIL ÇUMANAJ |
| LAVDOSH SHEFQET | REIS SHYQYRI MEMUSHAJ | NECO NIKO BOLLANO/ | SHQIPONJE MUHAMET TOZAJ | ZIGUR LIÇO DULOMATI |
| HASANALIAJ | RESMI DEMIR ZYKAJ | NECO NIKO BOLLANO/ | SHYQYRI GANI TOSKA | ZIJA HYSSEPI AVDULAJ |
| LEONARD MUHAMET AVDULI | SHERFI HIQMET HITAJ | NECO NIKO BOLLANO/ | SHYQYRI HAMIT MARRA | ZIJA RAMIS KOKAJ |
| LEONIDHA KICO BOMBAJ | RRAPO BARJAM MERKAJ | NECO NIKO BOLLANO/ | SHYQYRI VEIS KAZANXHI | ZIJA SKENDER MEHMETI |
| LEONIDHA THOMA RRAPAJ | | NECO NIKO BOLLANO/ | | |
| LEONIDHA THOMA RRAPAJ | | NECO NIKO BOLLANO/ | | |

DITA E PUNËTORËVE REAGIMET

Kreu i SPASH: Kushte të vështira e klasa kolektive, cungohet mësimdhënia

Mësuesit protestojnë para Ministrisë së Arsimit: Qeveria të mbajë premtimet

Nevrus Kaptelli: Rritja e pagave, mashtrimi i radhës

Voltiza Duro

Në ditën Ndërko mbëtare të Punëtorëve, mësues të arsimit parauniversitar kanë zgjedhur të protestojnë para Ministrisë së Arsimit. Me pankarta në duar, ata kanë marshuar nga Muzeu Historik drejt godinës së ministrit ku kanë shprehur shqetësimet e tyre. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", Nevrus Kaptelli, kreu i Sindikatës së Pavarur të Shqipërisë tregon problematikat kryesore të mësuesve, ndër to edhe premtimin e pa mbajtur nga qeveria për rritjen e pagave. Gjithashtu, ai thekson se mësuesit prej vitesh nuk marrin shpërblimet e fundviti, e shumë prej tyre, veçanërisht ata të zonave rurale kanë kushte të këqija pune e madje punojnë edhe me klasa kolektive. Kaptelli bën me dije se sindikata ka trajtuar një pjesë të shqetësimeve me sekretarin e Përgjithshëm dhe zv. ministrin, por një pjesë e tyre ende nuk kanë gjetur zgjidhje por ai shton se ministria ende s'ka gjetur kohë të ulet dhe të bisedojë me përfaqësuesit e mësuesve edhe pse i janë drejtuar edhe me kërkesë zyrtare me shkrim.

Pse protestuan mësuesit e arsimit parauniversitar ditën e sotme (dëshme)?

1 maji në kohën e diktaturës ishte ditë parakalimesh jo vetëm në Tiranë, por në të gjithë vendin. Ne pothuajse të gjitha vendet e botës në këtë ditë protestohet për kushte pune e paga më të mira ndërsa në vendin tonë për rreth 28 vite të pasdiktaturës është kthyer në ditë piknikësh. SPASH nëpërmjet protestës së sotme bëri të njëjtin veprim si edhe kolegët tanë në Evropë dhe në botë. Ne protestuan dhe kërkuam në shumë vëmendje për arsimin, buxhet më të lartë deri në 5% të GDP-së, kushte më të mira pune, paga dinjitoze, vlerësim moral e material të figurës së mësues-



Kreu i Sindikatës së Pavarur të Arsimit të Shqipërisë, Nevrus Kaptelli

PROBLEMATIKAT

Problemet që shqetësojnë sot mësuesit janë burokracitë shkresore në dokumentacion, pagat që janë më të ulëta në rajon e në Evropë, kushtet jo normale të punës, mungesa e dialogut social në të gjitha nivelet dhe moszbatimi i neneve të veçanta të ligjit, kontratës kolektive dhe akteve nënligjore.

it nga shteti etj.

Cilat janë disa prej problematikave që shqetësojnë më së shumti mësuesit?

Problemet që shqetësojnë sot mësuesit janë burokracitë shkresore në dokumentacion, pagat që janë më të ulëta në rajon e në Evropë, kushtet jo normale të punës, mungesa e dialogut social në të gjitha nivelet dhe moszbatimi i neneve të veçanta të ligjit, kontratës kolektive dhe akteve nënligjore.

A jeni të kënaqur me pagën dhe a ju paguhen orët shtesë?

Mësuesit nuk janë aspak të kënaqur me pagat që marrin, pasi siç thamë ato janë më të ultat nga gjithë kolegët e tyre në rajon dhe Europë. Mësuesit kërkojnë rritjen e pagave sipas premtimeve që ka bërë qeveria. Rritja prej 7% është e papranueshme dhe nuk justifikon punën e vështirë që bëjnë mësuesit. MASR është e detyruar me ligj dhe kontratën kolektive të punës për pagesën e orëve jashtë orari. Ne do të kërkojmë me këmbëngulje zbatimin e tyre dhe çdo të

drejtë që u takon mësuesve.

A është mbajtur premtimi i rritjes me 40% të pagës së mësuesve nga ana e qeverisë?

Qeveria jo vetëm nuk ka mbajtur premtimin për rritje 40% të pagave deri në fund të mandatit, pasi tashmë kanë kaluar 2 vite dhe paga duhej të ishte rritur 20%, por me sa duket ky do të jetë mashtrimi i radhës, si premtimi i pagës së 13-të.

Po në lidhje me shpërblimet e fundviti a keni arritur të gjeni një zgjidhje?

Kjo qeveri nuk ka ndërmend të na japë shpërblimet e fundviti. Ai mund të fitohet vetëm me akcion sindikale gjithëpërfshirës. Kur mësuesit të jenë gati për këtë ne jemi gati për t'i udhëhequr në çdo kohë.

A keni arritur të bisedoni me përfaqësues të Ministrisë së Arsimit apo vetë ministrin për shqetësimet tuaja? Cila është përgjigja që keni marrë nga MASR?

Kemi trajtuar një pjesë të shqetësimeve tona me sekretarin e Përgjithshëm dhe zv. Ministrin, por një pjesë e tyre ende nuk kanë gjetur zgjidhje.

PROTESTA

1 maji në kohën e diktaturës ishte ditë parakalimesh jo vetëm në Tiranë, por në të gjithë vendin. Ne pothuajse të gjitha vendet e botës në këtë ditë protestohet për kushte pune e paga më të mira ndërsa në vendin tonë për rreth 28 vite të pasdiktaturës është kthyer në ditë piknikësh. SPASH nëpërmjet protestës së sotme bëri të njëjtin veprim si edhe kolegët tanë në Evropë dhe në botë.



Ministria e Arsimit uron 1 Majin: Protesta, e drejtë e sindikatave

Pas protestës së mësuesve, Ministria e Arsimit në një reagim për mediat, ka theksuar se 1 Maji është ditë e denjë për të protestuar nga ana e sindikatave. "Në kuadër të protestës së sotme para ministrisë nga ana e Sindikatës së Pavarur të Arsimit, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) dëshiron të theksojë se protesta është një e drejtë dhe 1 Maji është pikërisht dita kur ushrohet kjo e drejtë nga sindikatave", bën me dije MASR. Kjo e fundit gjithashtu nënvizon se ky institucion ka dialog të vazhdueshëm me sindikatave për diskutimin e çështjeve të ndryshme si buxheti, nismat e reja dhe sidomos kontrata kolektive. "Kontrata përfshin të gjitha kërkesat e sindikatave dhe jemi të lumtur që rritja e përvitshme e pagës së mësuesit do të reflektohet në pagën e prillit, të cilën çdo mësues/e do ta ketë në llogarinë e tij/saj duke filluar që nga dita e nesërme. Ndër të tjera, MASR i uron përzemësisht 1 Majin të gjithë punëtorëve dhe sindikatave!", -thuhet në deklaratën e Ministrisë së Arsimit.





"Shqipëria po vuan emigrimin e shumë punëtorëve, veçanërisht atyre të kualifikuar"

Presidenti Ilir Meta: Papunësia në vend në nivele të papranueshme

Edi Rama kundërshton: Ka rënë 6% me ardhjen e PS në pushtet

Voltiza Duro

Në Ditën Ndërko mbëtare të Punëtorëve, Presidenti i Republikës Ilir Meta ka uruar 1 Majin por ka theksuar gjithashtu se Shqipëria sot ka një nivel të papranueshëm të papunësisë e vuan emigrimin e forcës punëtore. Meta apeloj për kushte më të mira e dinjitoze në vendin e punës. "Duke u uruar 1 Majin, Ditën e Punëtorëve, ndaj sot shqetësimin me të gjithë punëtorët, të sektorit publik dhe të atij privat, për kushte më të mira e dinjitoze pune dhe për respektim të legjislacionit, që garanton plotësisht të drejtat e tyre.

Me punën, mundin dhe energjinë e tyre, punëtorët kanë një kontribut thelbësor për zhvillimin, mirëqenien dhe përparimin e vendit. Por fatkeqësisht, Shqipëria ka ende një nivel të papranueshëm papunësie dhe vazhdon të vuajë largimin në emigrim të shumë punëtorëve, veçanërisht atyre të kualifikuar", shkruan presidenti në faqen e tij zyrtare në rrjetin social Facebook.

DETYRAT E SHTETIT
Presidenti Ilir Meta ka nënvizuar se shteti e ka për detyrë të hapë vende të reja pune dhe t'u sigurojë punëtorëve kushte Brenda standarde duke frenuar kështu emigrimin e duke hapur rrugën e zhvillimit ekonomik të Shqipërisë. "Është detyra e shtetit në radhë të parë të garantojë, jo vetëm hapjen e vendeve të reja, por edhe kushte më të mira pune, në mënyrë që kjo kategori vitale të ndërtojë të ardhmen dhe të kontribuojë këtu për zhvillimin ekonomik të familjes, shoqërisë dhe Shqipërisë", thekson Meta. Ky i fundit më tej nuk ka harruar të shprehë falënderimet për të gjithë emigrantët shqiptarë që kanë kontribuar në zhvillimin e ekonomisë së vendit. "Një falënderim të veçantë kam sot dhe për të gjithë emigrantët shqiptarë, që me punë të ndershme kanë dhënë një ndihmë të jashtëzakonshme kundër varfërisë dhe zhvillimit të vendit në vitet e vështira të tranzicionit", shkruan kreu i shtetit.



Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta

DEKLARATA E RAMËS

Në një kohë që presidenti Meta thekson se papunësia në Shqipëri është në nivele të papranueshme, kryeministri Edi Rama ka përdorur raportin e Bankës Botërore për të thënë se papunësia ka rënë me 6% më shumë. Në

postimin e tij në "Twitter" kreu i ekzekutivit shkruan se ndryshimet janë ndërjetë që me ardhjen në pushtet të partisë Socialiste, por, nga ana tjetër, nënvizon se ende ka shumë punë për t'u bërë. "Si pas Bankës Botërore, Shqipëria ka krijuar në vitin

2018 më shumë se gjysmën e vendeve të reja të punës që u krijuan vjet në rajon! Papunësia ka rënë më shumë se 6% qysh se morëm detyrën. Akoma shumë për të bërë, po askush s'ka bërë dhe s'bën dot kurrë sa ne"-shkruan Rama.

Shehaj: Pretendimet e Edi Ramës për papunësinë, qesharake

Sh-deputeti i PD-së Agron Shehaj i cilëson qesharake pretendimet e kryeministrit Edi Rama, referuar raportit të Bankës Botërore, që numri i papunësisë në vend është ulur ndjeshëm. Përmes një postimi në "Facebook", Shehaj shkruan se pavarësisht se është data 1 maj kryeministri Rama këtë ditë e ka 1 prill. "Është qesharake që Kryeministri i vendit u referohet studimeve të të huajve, të bazuar në të dhëna të sajura dhe të përgatitura prej qeverisë së tij, për të thënë që është ulur papunësia. Kryeministri e ka të thjeshtë: le të thotë se ku janë krijuar vendet e reja të punës në cilën industri dhe nga cilat biznese, ku ndodhen këto biznese, sepse kemi të bëjmë me 38.000 vende pune të reja, pa përfshirë vendet e punës që janë mbyllur.



PAPUNESIA

"Është qesharake që Kryeministri i vendit u referohet studimeve të të huajve, të bazuar në të dhëna të sajura dhe të përgatitura prej qeverisë së tij, për të thënë që është ulur papunësia".

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDORJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS

Publikohet traileri i filmit shqiptar që bëri bujë në Itali

"Vulë" shumë shpejt në Tiranë, regjisori Valmir Tertini zbulon detajet

Ja e fshehta e jetës geto dhe pasionit të shfrenuar të Viktorias

Egla Xhemali


Ka pak ditë që është publikuar traileri i filmit "Vulë", me regji të Valmir Tertinit. Ky produksion i fundit i regjisorit pritet që të jepet shumë shpejt premierë në Tiranë, për të vijuar pas disa ditësh në një festival konkretisht më datë 3 e për të kulmuar pastaj me premierën në Gjermani. Kujtojmë se ende pa u shfaqur filmi, ka marrë vlerësimin për skenarin më të mirë në Sirakuzë të Italisë. Historia e filmit vërtitet rreth Viktorias, një vajzë 28-vjeçare, që është dërguar nga shteti gjerman për në Ambasadën e Kosovës. Të gjitha aplikimet për vizën gjermane, dosjet shkojnë te Viktoria, ndërsa ajo është e papërgjegjshme në këtë drejtim, duke i lënë anash ato dhe duke u varur nga një jetë geto. Alkool, drogë dhe mungesa e një partneri që ta përmbushë. Në rolin kryesor atë të Viktorias, luan aktorja shqiptare Jorida Sorra, e cila vepron në Gjermani ku është pjesë e teatrit. Pjesë e filmit janë, gjithashtu, emra të njohur nga fusha e artit: Fatlume Bunjaku, Avni Dalipi, Kristina Dodaj, Edmond Hafizademi, Vlera Pylla, Nexhip Nexhipi, Denardo Neziraj, Donald Shehu etj. Regjisori dhe skenaristi i filmit "Vulë" na tregon detaje për skenat që kanë pasur më shumë dublat, ku pohon se kanë qenë të vështira për t'u realizuar dy skenat erotike që ka filmi, se si erdhi kjo histori tek ai si fillim, si një ide e se si u konkretizua në skenar, kompromiset për hir të punës që ia adreson qëllimit e vizionit, si dhe vështirësitë që ka hasur për ta realizuar atë. Ai thotë se Viktoria kurrsesi nuk mund t'i ngajë dikujt tjetër. Sa i përket emrit të filmit, Tertini pohon se "Vula" vjen në formën e një metafore, pasi ajo nuk shihet në asnjë pjesë të filmit. Në vetvete vula përfaqëson një cikël që është mbyllur. Pas vlerësimit në Itali, regjisori thotë se ka dëshirë që të dëgjojë edhe reagimin e ambasadave.



Kur një punë do ta finalizosh sa më mirë dhe të marrësh 'feedback'-un e merituar, natyrisht që duhet kohë.


Deri më tani fryma e përgjithshme për produksionin e fundit të Tertinit ka qenë mjaft e mirë.

Regjisori plot entuziazëm ka ndarë trailerin me publikun, pa harruar të falënderojë të gjithë bash-



këpunëtorët si dhe premtan se së shpejti do jetë në Tiranë. Përpos këtij projekti gjigant, Valmiri është

duke u marrë me një skenar tjetër, ndërkohë që pranon se ka goxha vështirësi në realizimin e një filmi.



Morena Tarku fiton çmimin e rëndësishëm në Turqi dhe ofendon ish-të dashurin e saj

Ka qenë në qendër të mediave rozë sidomos për lidhjen me miliarderin iranian, këngëtarja shqiptare, Morena Tarku prej disa kohësh po jeton në Turqi ku tashmë është bërë shumë e njohur. Madje bukuroshja 26-vjeçare së fundmi është vlerësuar me çmimin e rëndësishëm si "Këngëtarja më e mirë e huaj e muzikës Pop" në eventin "Turkiye Odulleri". Por, pavarësisht gëzimit për fitimin e këtij çmimi, me anë të një postimi në rrjetet sociale, Morena i ka dërguar një mesazh të qartë një nga ish të dashurve të saj. "Më kujtohet kur ish-i dashuri më tha, që ti nuk do t'i realizosh kurrë ëndrrat e tua. Rrugës për një çmim në muzikë", ka shkruar ajo, ndërsa shfaqet në makinë nga ku e ofendon pasi i tregon gishtin e mesit. Morena prej disa ditësh ka lajmëruar që do të sjellë një këngë me një këngëtar të njohur ndërkombëtar, pikërisht Jalal Oba.



"Skam rrëshqitur ende!" Pasi thumboi Alban Ramosajn, vjen reagimi i moderatorit

Moderatori i njohur ishte në dilemë se çfarë fotoje të postonte në 'Instagramin' e tij. Isli Islami kishte plot 999 postime dhe për foton e 1000-të ka kërkuar ndihmën e ndjekësve për të kuptuar se çfarë duan ata që ai të publikojë. Por, shumica e kërkesave të fansave, kanë qenë që ai të publikojë një foto nudo, e ngjashme si ajo e këngëtarit Alban Ramosaj. "Çfarë mendoni se duhet si postim i njëmijtë? Sugjeroni, sugjeroni", shkruan Isli, ndërkohë që fansat i kërkonin foto nudo. "Le të bëhemi një çikë seriozë dhe të mundohemi ta ndajmë seriozitetin nga shakaja. Nuk kam rrëshqitur ende", -shprehhet Isli duke ironizuar kështu Albanin. Pasi lajmi se Albani ishte thumbuar nga Isli u përhap në rrjet, ky i fundit për të qetësuar situatën publikoi në 'Instastoryn' e tij këngën e Alban Ramosajt, krahas së cilës shkruante: "Paqe vëllezër dhe merrni frymë thellë. Dashuri për të gjithë." - shoqëruar me një zemër të kuqe.



Nuk është Oriola! Modelja shqiptare që u bë pjesë e OTR-së ka gati këngën e parë

Dy modele mjaft seksi dhe të komentuar në show bizz-in shqiptar, u bënë pjesë e grupit OTR të reperit Noizy. Fillimisht ishte Oriola Marashi, të cilën prej kohësh e presim me ndonjë projekt muzikor e më pas Niki Delijorgji. E teksa aludohet se mes Oriolës dhe Noizyt mund të ketë ndodhur ndonjë zënkë, pasi ata nuk ndiqen në 'Instagram', sërish kemi mbetur konfuzë pasi Oriola ka postuar shpesh foto e video në koncertet e reperit ku duket se e mbështet. Vërtet diçka mund të ketë ndodhur mes Noizyt dhe Oriolës, pasi Niki, e cila ju bashkua OTR-së më vonë, e ka tashmë një këngë gati dhe këtë e ka zbuluar nëpërmjet 'Instastories'. Deri më tani dimë që kënga e saj i përket rrymës muzikore pop dhe duke qenë se do të dalë në verë, pritet të jetë mjaft ritmike. Nuk bëhet me dije nëse kënga do të vijë nën logon e OTR, pasi siç thamë më sipër vitin e kaluar bukuroshja u bë anëtarja më e re e grupit të Noizy-t.



Ylli botëror falënderon Blerim Destanin, ja për çfarë bëhet fjalë

Suksesi i Blerim Destanit duket se po kalon kufijtë duke arritur deri në Hollivood. Nëpërmjet një postimi në 'Instagram', aktori ka konfirmuar disa ditë më parë rolin e tij në filmin "The Poison Rose", producent të të cilit janë Jeff Elliot dhe Andrea Iervolino. Në këtë projekt filmik do të luajnë edhe dy aktorët me famë botërore Morgan Freeman dhe John Travolta. Para disa ditësh aktori i famshëm amerikan John Travolta ka publikuar trailerin e filmit në fjalë në llogarinë e tij në 'Instagram' dhe nuk ka munguar një koment në formë emoji nga ana e Blerimit. Siç mund ta shihni edhe në foton e mëposhtme të bërë publike nga Destani, ky i fundit i ka dërguar një emoji me duar lart që nënkupton një bravo të madhe për suksesin dhe bashkëpunimin, ndërkohë nga ana tjetër aktori amerikan e ka falënderuar aktorin shqiptar.



RRëfimi i shqiptares së përdhunuar përlot Kongresin Amerikan

Krasniqi dëshmon para komitetit: Polici serb më dhunoi për t'u hakmarrë ndaj UÇK -së

Vasfije Krasniqi, viktima e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, ka dëshmuar para Komitetit për Marrëdhënie të Jashtme të Kongresit Amerikan, tmerrin që e ka përjetuar nga forcat serbe. Ajo tregoi tmerrin që ka përjetuar kur ishte vetëm 16-vjeçare. Ndërsa Vasfija rrëfente se si është sulmuar dhe dhunuar seksualisht nga policët serbë, të pranishmit dëgjorin të përloitur. "Dua t'ju falënderoj që ma dhatë nderin që tregimin tim ta ndaj me ju. Më 14 prill kur isha 16 vjeçe një polic hyri në shtëpinë tonë dhe po e kërkonte babanë dhe vëllezërit e mi. Unë isha me nënën time. Ata na kërkuan

RRËFIMI I TË DHUNUARËS:

"Polici më mori dhe më dërgoi në një shtëpi dhe më hodhi në dysheme. Unë fillova të bërtas ndërkaj ai filloi të më dhunojë. Isha nën tytën e pushkës. Më keqtrajtoi. Më dhunonte dhe humba vetëdijen. Kur më erdhi vetëdija i kërkova të më vriste, por ai më tha 'jo, sepse kështu do të vuash më shumë. Dhe pati të drejtë. Më kujtohet që e kishte dorën e plagosur dhe tha se po merrte hakmarrje nga unë meqë sipas tij e kishte plagosur UÇK-ja", tha ndër të tjera e dhunuara.



letërnjoftimet. Pasi që e pa letërnjoftimin tim e mbajti dhe më tha të shkoj në stacionin policor të jap deklaratat për burrat e shtëpisë.

Në atë moment xhaxhi e pyeti se 'pse po e merr vajzën', ndërkaj polici i tha mos lëvizni se do t'ju vrasim. Nëna ime i tha 'më merrni

mua', por ata i thanë jo se ajo është fëmijë dhe nuk është në gjendje të gënjejë se ku e ka babanë dhe vëllezërit. Polici më mori dhe më dër-

goi në një shtëpi dhe më hodhi në dysheme. Unë fillova të bërtas ndërkaj ai filloi të më dhunojë. Isha nën tytën e pushkës. Më keqtrajtoi. Më dhunonte dhe humba vetëdijen. Kur më erdhi vetëdija i kërkova të më vriste, por ai më tha 'jo, sepse kështu do të vuash më shumë. Dhe pati të drejtë. Më kujtohet që e kishte dorën e plagosur dhe tha se po merrte hakmarrje nga unë meqë sipas tij e kishte plagosur UÇK-ja. Pasi më dhunoi, më la në një shëtitore aty afër dhe nuk guxova të bëj lëvizje, sepse ishte fshat i banuar me serbë. Më pas më nxori nga vetura dhe më dërgoi në atë shtëpi, dhe më dhunoi edhe një plak. Pastaj më lanë në fshat në rrugë. Eca në varrezat e fshatit, sepse nuk doja të kthehesha në shtëpi. Ata më mësonin edhe çfarë t'u them në shtëpi - të them që kam qenë

në stacion policor për të dëshmuar. Kur shkova në shtëpinë e xhaxhit, ata më panë dhe nuk kanë pasur nevojë të më pyesin sepse një 16-vjeçare nuk ka çfarë të dëshmojë në polici, duke më parë edhe në çfarë gjendje fizike isha. E raportova rastin në Komitetin e Bashkuar, pastaj në EULEX. Kryesit e krim-it janë identifikuar, por tani pas 20 vjetësh ata nuk kanë dhënë llogari për atë që më kanë bërë. Janë të lirë. Gjithçka që unë dua është drejtësia. Sot jam nënë e dy vajzave dhe ua them atë çfarë unë kam kaluar dhe nuk do të jem në paqe deri sa të shoh drejtësinë. Kërkoj përndjekjen e krimineleve duke marrë veprime të menjëhershme që do të ishte drejtësi për të gjithë të mbijetuarat", ka rrëfyer ajo në kongres.

Presidenti kosovar: Jemi të izoluar nga BE, duhet rezolutë për gjenocidin serb

Samiti i Berlinit, Thaçi: Kishte fjalime boshe e asgjë konkrete

Analisti gjerman: Takimi Kosovë-Serbi, shuplakë për Mogherinin

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në një intervistë për prestigjiozën "Financial Times", ka komentuar Samitin e Berlinit. Thaçi ndalet edhe të takimi i liderëve në Berlin të cilën e cilëson me fjalime boshe dhe pa asgjë konkrete. Ai nuk kursen as komentet ndaj BE-në, të cilën e cilëson jo vetëm të dobët, por të ndarë nga brenda dhe të shqetësuar nga populistët në zgjedhjet e Parlamentit Evropian që do të mbahen në maj. "Pa përfshirjen dhe rolin drejtues të SHBA-së, unë jam skeptik që dikush nga BE-ja mund të bëjë diçka. Roli i SHBA-së është vendimtar për një zgjidhje. Ajo çka ne po synojmë është njohja e Kosovës nga Serbia, dhe kështu rruga për anëtarësim në BE do të jetë e hapur për të dy shtetet. Por nuk do ketë kompromis për pavarësinë e Kosovës, përndryshe do të mbesim në një konflikt të ngrirë që do kish të pasojë për të ardhmen dhe do kish të mundësi për konflikt të ri. Jo vetëm unë, por të gjithë në nga regionin u ndamë të dëshpëruar nga takimi në Berlin. Nuk kishte asgjë konkrete, vetëm fjalime boshe. BE-ja është shumë e dobët dhe nuk është e bashkuar... Ata janë të okupuar me zgjedhjet në parlamentin e tyre dhe të frikësuar për rezultatin eventual. Prandaj të gjithë po veprojnë në një mënyrë taktike dhe politike, dhe nuk po mendojnë strategjikisht." - shprehet Thaçi. Ndërkaj, Bodo Weber, bashkëpunëtor i lartë i Institutit Transatlantik të Këshillit për Politikën e Demokracizimit, tha për Zërin e Amerikës se shpreson që takimi i Berlinit i organizuar nga kancelaria Angela Merkel dhe presidenti Emmanuel Macron, shënon përfundimisht "vdekjen e idesë për shkëmbim terriroresh", mes Kosovës dhe Serbisë. Ai tha se takimi dha "rezultatet që ishin realisht të mundshme- fillimin e një nisme të re të



vendëve kryesore të Bashkimit Evropian për të marrë udhëheqjen për t'i dhënë fund një periudhe dyvjeçare të së ashtuquajturës 'faza përfundimtare' e bisedimeve, që në sajë të kryenegociatores së BE-së, Frederica Mogherini, shkoj në një drejtim krejtësisht të gabuar dhe përfundimisht u bllokua dhe për të shkuar drejt një rivendosjeje të plotë të negociatave". Zoti Weber tha se "ishte e qartë që rifillimi nuk do të ndodhte në Berlin. Nuk mendoj që do të ndodhë as në Paris në takimin e radhës në 1 korrik. Me shumë mundësi do të ndodhë vetëm pasi trashëgimtari i zonjës Mogherini të marrë detyrën në vjeshtë". Vëzhguesit dhe analistët e kanë

cilësuar takimin e Berlinit edhe si një goditje ndaj zonjës Mogherini për shkak të qasjes së saj ndaj ideve për korrigjim kufijsh dhe shkëmbim terriroresh. "Përfundimisht ishte një shuplakë. Federica Mogherini përfundoi duke qenë më shumë një spektatore sesa një pjesëmarrëse. Dhe kjo pas dy vjetësh gjatë të cilave ajo ndryshoi rolin e saj si drejtuese e negociatave duke i rrëmbyer ato, duke mbajtur të pafinformuar kryeqytetet e Bashkimit Evropian dhe në një mënyrë duke e shndërruar veten në një aleate të presidentit (Aleksandër) Vuçiq dhe presidentit (Hashim) Thaçi, në vend që të mbrojtë interesat e BE-së kundrejt rajonit të Ballkanit",

tha zoti Weber. Ai shpreson që takimi "shënoi po ashtu vdekjen përfundimtare të idesë për shkëmbim terriroresh, edhe pse duket që presidenti Macron ka nevojë edhe për pak kohë për të kuptuar përse kjo ide e rrezikshme duhet dhe duhej të ndalej me qdo çmim", tha ai. "Edhe pse Serbia ka sjellje armiqësore dhe antievropiane nuk është penguar fare në rrugën e saj drejt integritimit evropian" ka thënë presidenti i Kosovës Hashim Thaçi. Ndërsa Kosova po mbetet e izoluar për shkak të bllokadave, të cilat sipas tij po i bëhen nga 5 vendet e BE-së që nuk e kanë njohur pavarësinë e saj. Ai ka thënë se marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë janë vazhdimisht të acaruara. Thaçi në një konferencë për media ka folur edhe për rrëfimin e Vasfije Krasniqit në Kongresin Amerikan për dhunën seksuale që ka përjetuar ajo gjatë luftës në Kosovë. Ka kërkuar nga Kuvendi që të nxjerrë një rezolutë për gjenocidin dhe krimet e kryera nga Serbia ndaj shqiptarëve në Kosovë. Sipas tij asnjë krim i kryer nga Serbia nuk duhet heshtur. Pas dy dekadash e mbijetuara e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, Vasfije Krasniqi-Goodman ka raportuar dje para Kongresit Amerikan për përjetimet e saj të tmerrshme të asaj kohe.

Shqiptarët protestë para ambasadës serbe në Washington

Të mbijetuar të dhunës në Kosovë dhe familjarë të viktimave, si edhe përfaqësues të komunitetit shqiptaro-amerikan, mbajtën të martën pasdite një protestë të planifikuar para ambasadës serbe në Washington, ku kërkuan drejtësi për krimet e kohës së luftës. E mbijetuara e dhunës seksuale nga forcat serbe Vasfije Krasniqi Goodman, e cila dëshmoi të martën paradite në Kongresin amerikan, tha se ishte shumë e rëndësishme që zëri i tyre u dëgjua dhe se shpreson që përmes angazhimit të Kongresit amerikan, të çohet drejtësia në vend. "Është një punë që është dashur të hapej edhe më herët. Pak me vonë, por më mirë vonë se kurrë dhe unë e kam kauzën të luftoj për drejtësi dhe të thej stigmen jo vetëm në Kosovë, por edhe në gjithë botën, ku kanë ndodhur dhunime gjatë luftërave". Ajo e pranon se për të nuk ishte e lehtë të protestonte para ambasadës së Serbisë. "Por kjo është t'u tregoj atyre se ne nuk ndalem para se drejtësia të shkojë në vend dhe që ata t'i pranojnë krimet që kanë kryer; të kërkojnë falje për krimet dhe të dënohen kriminelët. Kështu që ndihem krenare që jam para ambasadës serbe, t'i tregoj këtyre që ne shqiptarët duam drejtësi. Jo hakmarrje, por drejtësi", thotë ajo. Anëtar i Këshillit bashkiak të Nju Jorkut, Mark Gjonaj, që, sapo është kthyer nga Kosova, ishte një prej protagonistëve të protestës. "Sot është një ditë që mbas 20 vjetëve të kujtohen gabimet, dëmi që ka ndodhur në Kosovë. 20 mijë femra janë përdhunuar, 13 mijë vetë kanë vdekur, 1620 janë zhdukur. Kemi filluar një lloj lobia të fortë, të vazhdueshmë t'i vëmë presion Serbisë që kriminelët e luftës të paraqiten para gjykatës, që t'i gjykojmë ne. Zoti do t'i gjykojë në jetën tjetër", tha ai. Ilir Bytyqi, që edhe në Kongres foli për domosdoshmërinë e vënies para përgjegjësisë të fajtorëve, tha në protestë se Serbia duhet të arrestojë shqaktarët e këtyre krimeve. Në përgjigje të Zërit të Amerikës, dy vetë nga personeli i ambasadës së Serbisë në Washington thanë për Shërbimin Shqip se protesta "nuk do të thotë asgjë". "Është një vend demokratik dhe gjithkush mund të protestojë", thanë ata.

Ushtria përçahet pas thirrjeve të Guaidos: Para drejtësisë, autorët e kryengritjes

Venezuela në prag të luftës civile, Maduro: Grushti i shtetit dështoi

Karakas kthehet në arenë lufte, 70 persona mbetën të lënduar

Protestuesit opozitarë mbështetës të presidentit të vetëshpallur, Juan Guaido, pas orë të tëra përplasjes mes qytetarëve dhe ushtrisë, nuk arritën të përmbysin pushtetin e presidentit Nikolas Maduro. Ditën e djeshme, kryeqyteti Karakas dhe disa qytete të mëdha u shndërruan në arenë përleshjesh mes dy kampeve. Fatmirësisht, asnjë viktimë nuk u regjistrua. Rreth 70 persona mësohet se kanë mbetur të lënduar, disa prej tyre me plagë plumbash në trup. Pamjet e përplasjeve bënë xhiron e botës, ndërsa forcat ushtarake përdorën edhe makinat për të shtypur protestuesit. Pas rezistencës në ditën e parë, presidenti Nikolas Maduro doli në një fjalim përpara popullit, ku tha se një grup i vogël protestuesit dështuan në planin e tyre për grusht shteti. Edhe Shtetet e Bashkuara mbështesin presidentin e vetëshpallur Guaido. Administrata amerikane njoftoi se Maduro ishte shumë pranë rënies dhe kishte përgatitur planin e arratisjes në Kubë. Këtë të mërkurë priten përleshje të tjera edhe më të dhunshme. Ndërkaq, zona përreth bazës ushtarake ajrore "La Carlota" në verilindje të Karakasit është fushëbetëje e parë e përplasjes, që nisi këtë të martë në Venezuelë mes forcave që iu bashkuan opozitës pro-perëndimore dhe ushtarëve besnikë të presidentit majtist Nikolas Maduro. Mijëra përkrahës të presidentit në përkrahshëm të njohur nga perëndimi,



Pamje nga protestat në Karakas, Venezuelë

Juan Guaido dhe ushtarët armatosur mbështetës të tij u përpoqën të pushtojnë aeroportin ushtarak. Por forcat e rreshtuara në krah të Maduroso kundërpërgjigjen me të shtëna në ajër dhe gaz lotsjellës për t'i shpërndarë. Përleshje pati në disa zona të kryeqytetit, por për fat të mirë nuk pati të lënduar. Guaido i drejtohej nga terreni përkrahësit të tij. Ushtarët që e mbështesin liru-

an njërin nga liderët e burgosur të opozitës, Leopoldo Lopez, të arrestuar në trazirat e 2014-s kur Maduro u zgjodh president. Aksioni i opozitës për të marrë nën kontroll shtetin nisi pasi në orët e para të mëngjesit, Guaido publikoi një video ku i bënte thirrje ushtrisë të dezertonte dhe të bashkohej me opozitën për të rrëzuar Maduroso. "Populli i Venezuelës, të dalim në rrugë për t'i

dhënë fund uzurpimit. Forcat kombëtare të armatosura kanë marrë vendimin e drejtë. Ata kanë mbështetur popullin dhe Kushtetutën. Ata kanë marrë anën e drejtë dhe të sigurtë të historisë". Edhe Maduro u bëri thirrje me "Twitter"-it, ushtrisë dhe mbështetësve të tij të mobilizoheshin për të mbrojtur vendin. Thirrjes iu përgjigjen mijëra banorë të Karakasit që rrethuan

për ta mbrojtur pallatin presidencial. Shtëpia e Bardhë njoftoi se presidenti Trump po e ndjek nga afër situatën. Mbështetjen për opozitën e shprehën përmes "Twitter"-it, sekretari amerikan i shtetit Mike Pompeo dhe këshilltari i Trump-it për sigurinë John Bolton, të cilët thanë se Shtetet e Bashkuara qëndrojnë përkrah popullit të Venezuelës.

HUAN GAUIDO

"Populli i Venezuelës, të dalim në rrugë për t'i dhënë fund uzurpimit. Forcat kombëtare të armatosura kanë marrë vendimin e drejtë. Ata kanë mbështetur popullin dhe Kushtetutën. Ata kanë marrë anën e drejtë dhe të sigurtë të historisë", tha Guaido në thirrjen e tij për të rrëzuar Maduroso.

SHKURT

Merret vendimi, Assange dënohet me 50 javë burgim

Një gjykatë britanike ka dënuar themeluesin e kompanisë "WikiLeaks", Julian Assange me 50 javë burgim, për shkak të shkeljes së rregullave të lirimimit me kusht. Australiani 47-vjeçar është shpallur fajtor për shkelje të Aktit për Lirim me Kusht, pas arrestimit që i është bërë në Ambasadën e Ekuadorit në Londër. Assange ka qëndruar si refugjat në këtë ambasadë nga viti 2012, për t'i ikur ekstradimit në Suedi, ku pritej të përballje me dyshimet për sulme seksuale dhe dhunime. Ai ka mohuar vazhdimisht këto pretendime, ndërsa hetimet për këto raste kanë pushuar një vit më parë. Aktualisht ai përballlet me akuzën për komplot nga gjykata federale e Shteteve të Bashkuara, për shkak të publikimit të sekreteve qeveritare. Britania pritet të vendosë nëse do ta ekstradojë atë në SHBA, megjë mund të dënohet me rreth 5 vjet nëse shpallet fajtor.

2 viktima nga sulmi në një universitet në SHBA

2 studentë mbetën të zvarrë në një sulm me armë në një Universitet në Karolinën e Veriut. Katër persona u plagosën, 3 prej tyre në gjendje të rëndë. Gjithçka ndodhi gjatë orarit të mësimt, kur 22-vjeçari Tristan Terrell nisi të qëllonte me pistoletë ndaj studentëve. Dëshmitarët rrëfyan për mediat amerikane se ishte një nga oficerët që bllokoi agresorin, duke parandaluar një masakër në universitetin me 30 mijë studentë. Autoritetet njoftuan se autori nuk ishte një element i shtuar si kriminal.

Punëtorët përleshën me policinë për 1 Majin në Europë

Manifestimet e shumta u zhvilluan në qytetet kryesore europiane nga sindikatat e punëtorëve me rastin e 1 Majit, të cilët kërkojnë përmirësim të kushteve të punës apo dhe paga më të larta. Në Torino protestuesit u përplasën me forcat e rendit. Rreth 20 aktivistë të sindikatave të punëtorëve u arrestuan në Stamboll. Në Shën Pjetërburg pati gjithashtu të arrestuar. Në Francë, masat e sigurisë ishin të jashtëzakonshme pasi këtë vit protestave të punëtorëve iu bashkuan edhe "jelektë e verdhë", të cilët vijojnë të kërkojnë ulje të taksave. Më shumë se 7400 policë u angazhuan vetëm në Paris, për të parandaluar trazira si në muajt e fundit. Protesta paqësore pati edhe në Berlin, ku mijëra manifestues bënë thirrje për përmirësim të kushteve të punës.

Së shpejti, rëfimi i plotë i historisë së dashurisë në një libër

"Ishte vetëm 17 vjeç", si Zonja e Parë e Francës joshi presidentin Emmanuel Macron

Brigitte dhe Emmanuel Macron janë një nga çiftet më interesante të politikës botërore. Presidenti i Francës u dashurua me Brigitte kur ishte vetëm 16 vjeç dhe në atë kohë ajo ishte mësuesja e tij. Mes tyre ka një diferencë 25-vjeçare. Brigitte ishte një grua e bukur, e martuar me një bankier me të cilin ka 3 fëmijë. Ajo braktisi babain e fëmijëve për një nga nxënësit e saj, Emmanuel, i cili ishte në klasë me një prej fëmijëve të Brigitte. Historia e plotë e dashurisë së çiftit presidencial pritet të zbulohet në një libër, që do të dalë në treg ditët në vijim. Gazetarja Sylvie Bommel, e cila shkruan



për gazetën "Le Journal du Dimanche", do të nxjerrë në shitje librin "Ai ishte

vetëm 17 vjeç" në lidhje me historinë e Brigitte dhe Emmanuel Macron.

Gazetarja e paraqet Brigitte Macron si "Zonjen Bovari" të kohëve moderne. Vajza e Brigitte, Laurence, ishte në klasë me Emmanuel dhe një ditë kur po ktheheshin nga shkolla i tha të ëmës: "Mami, në klasën tonë është një djalë i çmendur që di gjithçka për çdo gjë". Me kalimin e kohës, ata u njohën dhe Emmanuel i shprehte dashurinë mësueses së tij duke përdorur librat si burim frymëzimi, sikurse është "Zonja Bovari". Kur Emmanuel hyri në jetën e Brigitte, ajo ishte e martuar me bankierin Andre Ozie për 20 vite. Në

libër, gazetarja e përshkruan ish-bashkëshortin e Brigitte si një njeri të zgjuar dhe të sjellshëm, por të mërziqshëm. Një mikeshë e Brigitte Macron thotë: "Ishte shumë indiferent. Ndërsa ajo gjithmonë shkëlqente". Ozie nuk dihet nëse është martuar përsëri dhe asnjëherë nuk ka komentuar publikisht ish-bashkëshortin e tij Brigitte. Emmanuel dhe Brigitte Macron u martuan në vitin 2007. Brigitte ishte 54 vjeç dhe Emmanuel 29. Diferenca e madhe e moshës për ta nuk kishte vlerë, përkundrazi ishin shumë të lumtur.

Ndërtuan në tokën e shtetit ose të të tretëve, marrin tapitë për tokën

Lista me 500 pronarë që u miratohet e drejta mbi truallin

Përfituesit Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan dhe Korçë

Miratohet lista me personat që kanë ndërtuar pa leje dhe fitojnë të drejtën e pronësisë mbi sipërfaqet ndërtimore. Me një vendim të veçantë, qeveria ka përcaktuar metra katrorë për parcelat ndërtimore në Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan dhe Korçë. Janë 500 përfitues në të gjithë vendin, të cilët do të marrin tapitë për truallin mbi të cilin kanë ndërtuar. Në listën e miratuar nga qeveria janë përcaktuar sipërfaqet për çdo përfitues, ndërsa ngarkohet ALUIZNI për pasyrimin e tyre në dokumentet përkatese. Përfituesit do të mar-

rin tapitë për sipërfaqet e përcaktuara në VKM, pavarësisht sipërfaqes që kanë deklaruar në procesin e vetëdeklarimit të ndërtimit pa leje. Përfituesit kanë mbyllur të gjithë detyrimet dhe

pritet të marrin tapinë për tokën.
KALIMI I PRONËSISË
Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi parcelën ndërtimore të objektit pa leje bëhet sipas dispozitave të

Kodit Civil. Sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalimi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërtimit dhe për ndërtimet pa leje me funk-

sion banimi jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërtim i shiten

poseduesit të ndërtimit pa leje sipas vlerës së pronës, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin nëpërmjet një kërkesë me shkrim.

PRONARËT QË U MIRATOHET E DREJTA MBI TRUALLIN

| Nr. rendor | Të dhënat e Pasurisë së | | | Sipërfaqja për kalim pronësie (m ²) |
|-------------------------------------------------------|-------------------------|------------------|----------------------|-------------------------------------------------|
| | Emër | Atësi | Mbiemër | |
| 1 | AGIM | SHAHIN | MUÇA | 121 |
| QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 3165 | | | | |
| 2 | BATJA | KADRI | HAJDËRANJ | 322 |
| 3 | SHKËL | SADUSH | PUTRO | 160 |
| 4 | SHKËL | SADUSH | PUTRO | 440 |
| QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 8501 | | | | |
| 5 | PELLUM MAJLIN | SHEFIT NAZMI | KALEMASI KALEMASI | 208.9 |
| 6 | AJET ANA | QAZIM LEKO | VAVLA VAVLA | 302 |
| 7 | JULIA | MYFTAR | VREKO | 300 |
| 8 | SKËND MIMOZA | FASLLI ASQERI | BOBOÇI BOBOÇI | 91 |
| 9 | KRIST | SPIRO | HAXHISTASA | 286 |
| 10 | RUKU | HAMDI | CINGO | 183 |
| 11 | SOSE | FERIT | KAJO | 122 |
| 12 | BASHKI | MYSLIM | ARAPI | 171.3 |
| 13 | PRANVE | SAMEDI | HAXHIALIU | 292.7 |
| 14 | PËRPA | PAJO | ÇUNI | 185.2 |
| 15 | ANDRE | AMET | SARAÇI | 162 |
| 16 | ESTREF XHEVAJ | NOVRUS NOVRUS | BEQARAJ BEQARAJ | 500 |
| 17 | GAZME | YZEDIN | SPAHIU | 24.9 |
| 18 | SHYQY | BASHKI | KËRPIÇA | 12.8 |
| 19 | ARTJAN | BESTAR | VOKOPOLA | 26 |
| QARKU FIER, ZVRPP LUSHNJË, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 20 | MERUS | HASLLA | ZANI | 310 |
| | SILVANA | ABEDIN | LIÇAJ (ZANI) | |
| | DELVIN | ABEDIN | ZANI | |
| | GJONI | ABEDIN | ZANI | |
| QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 2525 | | | | |
| 21 | SOTIR | VANGJE | GRAMATIKO | 110 |
| QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 1217 | | | | |
| 22 | JANI | SHAHIN | GJIKA | 51.2 |
| 23 | JANI | SHAHIN | GJIKA | 57.6 |
| QARKU Berat, ZVRPP Berat, ZONA KADASTRALE 3555 | | | | |
| 24 | BURA | BESNI | MALASI | 780 |
| QARKU Berat, ZVRPP Kuçovë, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 25 | ARMAN | BARJA | DYRMA | 120 |
| 26 | VERA | BALIL | LINO | 119.3 |
| 27 | KRENA | FEJZI | SHKURTI | 300 |
| DREJTORIA E ALUIZNI-ELBASAN | | | | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 28 | BAJRAM | QAMIL | PLAKU | 324.9 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 29 | KADRI | HYSNI | BAKU | 45.6 |
| | FATJON | KADRI | BAKU | |
| 30 | ARTAN | MUSA | HALILI | 1500.6 |

| QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA | | | | |
|------------------------------------------------------|---------|---------|------------|--------|
| 31 | ROLAN | REXHE | BUZRA | 167.1 |
| 32 | ROLAN | REXHE | BUZRA | 96.9 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 33 | ROLAN | SHAMO | ARANI | 51.2 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 34 | HAMDI | BEHEXH | LAZI | 9.5 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 35 | BARDH | NEZIR | GJELI | 42.7 |
| | ISMET | QANI | GJELI | |
| | EDMON | SHEFK | BEJKOLLI | |
| | ZAMIR | RAIT | BEJKOLLI | |
| | DHIMITË | JOSIF | ÇAKALLI | |
| | VITOR | KOL | ÇAKALLI | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 36 | ZEQIR | ISMAL | SLAMI | 74.3 |
| 37 | ASHKI | MEÇAN | TRIMI | 96 |
| 38 | AGIM | EMIN | PISHA | 180.5 |
| | ALMA | TEFIK | PISHA | |
| 39 | MIT-HAT | MYRTE | BALLA | 478.6 |
| 40 | FADIL | MAHM | DEDA | 158.6 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 41 | XHEVAT | SHEFK | CIRONGU | 367.5 |
| QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA | | | | |
| 42 | LEONA | JONUZ | LLESHANAKU | 79.3 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 43 | HALIT | IBRAHIM | MUÇA | 500 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 44 | DRINI | SELIM | KYÇYKU | 670 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 45 | SHABAN | ISUF | VELA | 348 |
| 46 | SHEF | MURAT | ÇALA | 222 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 47 | NAMIK | IBRAHIM | EMINI | 417.6 |
| 48 | BUJAR | SHEFIT | TABAKU | 255.3 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 49 | SOTIR | DYLBËR | ZAIMI | 414.9 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 50 | ASTRI | SOTIR | TOSKA | 327.6 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 51 | SEJDI | SHERIF | BAJRAMI | 313.95 |
| 52 | KADRI | SHAMET | ÇEPA | 398.52 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 53 | SHAHI | SELMAN | BEZATI | 251.52 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 54 | VASIL | ARIF | PEPA | 241.42 |
| | NEXHMI | MEHMET | PEPA | |
| | LEONA | VASIL | PEPA | |
| | ARTA | SHAZIMA | SULÇE | |
| 55 | ARJAN | ALI | SULÇE | 147.57 |

| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
|------------------------------------------------------|---------|---------|-----------|--------|
| 56 | BESNI | IZET | META | 306.9 |
| 57 | FLORE | TRIM | HIDRI | 55.8 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 58 | AVNI | HAXHI | KOÇIU | 288.36 |
| 59 | AGIM | JACE | TABAKU | 342.30 |
| 60 | GRAMO | RRAPUS | SOLLAKU | 226.02 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 61 | FATOS | HAXHI | VIDHANI | 285.9 |
| 62 | BRDHY | ZABIT | KAVAJA | 274.8 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 63 | NIKOLL | MYSLIM | DEBROVA | 67 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 64 | SHPRESA | ZYLËF | TOSKA | 387.9 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 65 | KUJTIM | SABRI | BODURRI | 274.5 |
| 66 | ALEKSAN | VITI | ÇAKALLI | 407.1 |
| 67 | BESIM | DERVIS | ELEZI | 500 |
| 68 | HYSNI | SELIM | ROÇI | 298.8 |
| 69 | MALIQ | HAJDIN | HOXHA | 261.3 |
| 70 | HYQMET | ASIM | LLESHI | 406.2 |
| 71 | HAZIS | KASËM | PREÇI | 349.2 |
| 72 | VALTER | VITI | ÇAKALLI | 347.4 |
| 73 | ILIR | HASAN | MURATI | 261.6 |
| 74 | EMIN | OSMAN | KUQUJA | 318.9 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Gramsh, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 75 | RUSHAN | KAMBER | DRIZA | 281.1 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Gramsh, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 76 | HYSNI | TAHIR | LUTA | 25 |
| 77 | RAMAZAN | ASIM | MUHA | 145.6 |
| 78 | FATIME | NURI | KASTRIOTI | 260.8 |
| 79 | PËLLUMB | ADEM | BORA | 283.5 |
| | ANILA | JORGJI | BORA | |
| | ANDREA | RESHIT | DHIMA | |
| | ZAIM | TAFIL | DUSHA | |
| 80 | ZEGJINE | SABRI | DUSHA | 26 |
| | RRAMAN | NURI | ÇONIKU | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Gramsh, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 81 | BLERINA | RIZA | BRAÇJA | 336.3 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Gramsh, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 82 | BASHKIM | LAME | SENKO | 500 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Gramsh, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 83 | MİÇO | ISLAM | TOÇILA | 281.7 |
| 84 | SKENDE | QAMIL | SALLA | 500 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 85 | LULZIM | XHAFFER | SINA | 277.8 |
| 86 | ARBEN | SHAHIN | KASA | 265.5 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 87 | BAJRAM | AHMET | SHEHI | 16.7 |
| | EMINE | KASËM | SHEHI | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 88 | NEZIR | FETA | BAHO | 322.8 |

| | | | | |
|------------------------------------------------------|----------|---------|-----------------|-------|
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 89 | LUTFI | JAHO | ÇELA | 251.1 |
| 90 | FATI | SHEFQE | KIKIJA | 294.3 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 91 | XHAFER | SABRI | GOSTIMA | 322.2 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 92 | JONUZ | LIMON | SINA | 426.3 |
| 93 | GANI | ZEQIR | KULLAFI | 372.6 |
| | TEKI | GANI | KULLAFI | |
| | BESIM | GANI | KULLAFI | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 94 | POLIMER | MINA | PALIS | 85.2 |
| | MINA | FILIP | PALIS | |
| | LIRI | | PALIS | |
| 95 | BASTRI | BEQIR | HOXHOLLARI | 190.8 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 96 | HAVA | XHEMA | TOROMANI | 427.2 |
| | NDRIÇIM | BILAL | TOROMANI | |
| | FATBARD | BILAL | KUQJA(TOROMANI) | |
| | ANTONET | BILAL | KASNECI(TOROMA) | |
| | ARJAN | BILAL | TOROMANI | |
| 97 | SEIT | RAMAZ | SHARRA | 72 |
| 98 | ARMAND | IRFAN | ELMAZI | 188.5 |
| | MARKO | IRFAN | ELMAZI | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 99 | ALBERT | ASHKI | TRIMI | 80.8 |
| | MAJLINDA | VELI | TRIMI | |
| | HIQMET | HALIL | HALILI | |
| | LULJETA | ISLAM | HALILI | |
| 100 | VATHI | HYSEN | KURANI | 36.9 |
| | RAZUJE | TAULL | KURANI | |
| | RUDI | SHYQY | CERRIKU | |
| 102 | ISLAM | ÇUNI | SHUKULLI | 207.9 |
| 103 | SPIRO | VASIL | TORE | 276 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 104 | KUJTIM | REXHE | TASHI | 324 |
| 105 | ILIR | RAMAZ | BIÇAKU | 364.5 |
| 106 | SERVET | XHEMA | BAJRAMI | 335.5 |
| 107 | ELVIR | XHEVIT | BASHA | 271.5 |
| 108 | NIKOLLA | MERK | KUQJA | 326.4 |
| 109 | ALBERT | HAZIZ | GURABARDHI | 315.9 |
| 110 | NEZIR | MEHM | KOVAÇI | 257.1 |
| 111 | ISA | ASLLA | BAJRAMI | 232.5 |
| 112 | ETHEM | RAMAZ | TAHIRI | 381.9 |
| 113 | BESIM | NAZIF | TAHIRI | 397.2 |
| 114 | LUAN | GANI | MUZHQAQI | 339 |
| 115 | TOMORR | ALI | SOLLAKU | 348.6 |
| 116 | LUAN | ISLAM | TAHIRI | 384.3 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 117 | ALBER | HAKI | SHARRA | 221.8 |
| 118 | FERIT | FEJZULL | OSMANI | 286.2 |
| 119 | KUJTI | SHEFQE | SHARRA | 201 |
| 120 | RYZH | HAZIS | STËRMUGU | 300.3 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 121 | XHEZMI | PASHO | SULA | 153 |
| 122 | IDAJE | RAMAZA | HASKURTI | 271.8 |
| 123 | AFRIM | IDAJET | HASKURTI | 322.5 |
| | IBRAHIM | DESTAN | QOKU | |
| 124 | ARDIA | BEQIR | PISHA | 237.4 |
| 125 | ABDULL | VELI | RUÇI | 305.7 |
| 126 | BEXHET | SHABAN | XHAFA | 218.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 127 | HAXHI | HYSEN | SINA | 382.5 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 128 | TAULAN | AQIF | XHYRA | 290.1 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 129 | EDLIR | DHIMITE | BOJA | 31.9 |
| | FLAJDI | FLAMUR | BOJA | |
| 130 | EDLIR | DHIMITE | BOJA | 138 |
| | FLAJDI | FLAMUR | BOJA | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 131 | ENVE | KADRI | SALLA | 290 |
| 132 | NDRIÇI | GANI | BARDHI | 423.3 |
| | GANI | RRAPUS | BARDHI | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 133 | ARDIA | SULEJM | BOJA | 222.9 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |

| | | | | |
|------------------------------------------------------|--------|---------|-----------|-------|
| 134 | PERPA | HEKURA | DYRMA | 320.1 |
| 135 | NDRIÇI | ZEHNI | VELIU | 492.3 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 136 | AGIM | JORGJI | GJIKA | 382.8 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 137 | HYSE | DAUT | DAUTI | 342.3 |
| 138 | FIZE | REXHEP | AGO | 8.1 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 139 | SKEND | RAMAZA | KOÇI | 153.9 |
| | MELEQ | HAZIZ | KOÇI | |
| 140 | XHEVAH | BAFTJAR | SALIAJ | 500 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 141 | NESHAT | SHAMET | SHERMADHI | 126.2 |
| 142 | VASIL | TASI | TRUSHI | 240 |
| 143 | ASTRI | ADEM | QOLI | 60.1 |
| 144 | ASTRI | ADEM | QOLI | 169.5 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 146 | GENTIA | THANAŞ | GJOKA | 371.6 |
| QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE | | | | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 148 | YLLI | MUSTAF | TABAKU | 56.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 149 | ELMAZ | XHAFER | SALLA | 364 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 150 | PETRI | ABAZ | ÇULLHAJ | 333.3 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 151 | LUKA | MAKS | SULA | 313.5 |
| 152 | ILIR | CAUSH | SULA | 389.4 |
| QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE | | | | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 155 | GENTI | VASIL | MUFALI | 401.1 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 156 | PRENI | MARK | QOSJA | 285 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 157 | ARTAN | THOMA | BERATI | 82.8 |
| | ELVIR | FADIL | BERATI | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 158 | BUJAZ | XHAFA | SARAÇI | 22.4 |
| 159 | REMJI | AGUSH | SALKURTI | 44.4 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 160 | JORGJ | ILIA | GUXHA | 205 |
| 161 | ELVIR | PANDE | NARAZANI | 212.4 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 162 | FERDI | STEFA | BEZHANI | 348.3 |
| 163 | AGIM | MALIQ | MIFTARI | 457.2 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 164 | ISMAL | ALI | AGO | 500 |
| | NATASH | HAZIS | AGO | |
| 165 | ILIR | QAZIM | QOSE | 137.3 |
| 166 | MERK | KOSTAN | PANXHI | 500 |
| | TOMOR | MERK | PANXHI | |
| 167 | GRAMO | ALI | GJUNI | 137 |
| | ARBI | RAMAZ | HOXHA | |
| 168 | DURIM | YZEIR | BRAHO | 176.1 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Elbasan, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 169 | KUJTI | SALI | HOXHA | 348 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 170 | GEZIM | NAZMI | PEQINI | 304.5 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 171 | BERHA | PETRIT | BIXI | 450 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 172 | ILIR | TAFIK | MONI | 335.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 173 | SHPETI | DIELL | GOSENI | 362.4 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 174 | NAMIK | RESUL | SULA | 500 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 175 | ALTIN | ISMAL | KAVAJA | 324.9 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 176 | DEJE | AHMET | VRAPI | 446.7 |
| 177 | HYSNI | SEFED | BULLARI | 410.7 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 178 | GAZMI | ELMAZ | HOKJA | 325.2 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 179 | GRAMO | DYLAV | LANKJA | 433.5 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 180 | MUSTAF | JANUZ | ÇULLHAJ | 186 |

| | | | | |
|------------------------------------------------------|---------|--------|----------|-------|
| 180 | MUSTAF | JANUZ | ÇULLHAJ | 186 |
| | HEKUR | MUSTA | ÇULLHAJ | |
| 181 | FLORE | IBRAHI | KRECI | 289.8 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 182 | BARDH | ISMAL | BRAHJA | 301.5 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 183 | QANI | RIZA | BEQIRI | 328.5 |
| | SHPRE | BAJRA | BEQIRI | |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 184 | GEZIM | ALI | BALLHYSA | 446.7 |
| 185 | FERUZE | XHAFA | SALLUFI | 500 |
| 186 | LUSI | QAZIM | MINOLI | 432 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 187 | KASTRI | DIELL | DALLUPI | 470 |
| QARKU Elbasan, ZVRPP Peqin, ZONA KADASTRALE | | | | |
| 188 | QANI | RIZA | BEQIRI | 486.6 |
| QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN, ZONA KADASTRALE | | | | |
| DREJTORIA E ALUIZNI-T LUSHNJE | | | | |
| QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 8571, ZVRPP | | | | |
| 190 | VLADIMI | RAMAZA | KUKA | 250 |
| QARKU FIER, ZONA KADASTRALE 1492, ZVRPP | | | | |
| 191 | ALDI | LONI | GORREJA | 136 |
| 192 | ALDI | LONI | GORREJA | 492 |
| DREJTORIA E ALUIZNI-T TIRANE (VERI) | | | | |
| QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8370, ZVRPP | | | | |
| 193 | GAZME | QERAM | TOMINI | 117 |
| | ARTAN | KRISTO | PECI | |
| QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 3292, ZVRPP | | | | |
| 194 | REXH | HAXHI | XHEMO | 395.1 |
| DREJTORIA E ALUIZNI-T TIRANË-2 | | | | |
| QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8260, ZVRPP | | | | |
| 195 | HASAN | SEFED | DALIP | 25.00 |
| 196 | MIMOZA | KADRI | RUSTAJ | 64.30 |
| | PRANVER | HYSEN | FIDA | |
| | EDLEVA | AHMET | VORPSI | |
| 198 | ANILA | AHMET | VORPSI | 10.05 |
| | SHKELQI | MEXHIT | HYSA | |
| 199 | SHKELQI | MEXHIT | HYSA | 29.70 |
| | HARILLA | ANDON | SPIRO | |
| 200 | ABAS | SHEFQE | THANA | 12.60 |
| | LIDRA | REFIK | JOCA | |
| 201 | ALBA | FATOS | JOCA | 11.40 |
| | EUGEN | FATOS | JOCA | |
| 202 | MURAT | ISMAL | KORE | 6.00 |
| | MURAT | ISMAL | KORE | |
| QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8210, ZVRPP | | | | |
| QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8130, ZVRPP | | | | |
| 203 | NAMIK | SADIK | HODO | 11.40 |
| | MARK | NDUE | PICA | |
| 204 | ALEKSAN | SHABAN | RIZO | 6.00 |
| | IRISA | IRAKLI | RIZO | |
| 204 | ANDI | IRAKLI | RIZO | 53.90 |
| | NAMIK | SADIK | HODO | |
| 204 | MARK | NDUE | PICA | 53.90 |
| | HEKTO | SKENDE | JANINA | |
| QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8270, ZVRPP | | | | |
| 204 | LIRI | HEKURA | METUSHI | 53.90 |
| | KLODIA | BESIM | DULE | |
| | EDUAR | BESIM | METUSHI | |
| | ALKETA | BESIM | RRYTA | |
| 204 | ARQILE | MILO | QENDRO | 53.90 |
| | HEKTO | SKENDE | JANINA | |
| QARKU TIRANE, ZONA KADASTRALE 8270, ZVRPP | | | | |
| PASAZH | | | | |
| SOKO ZIVER MEKO | | | | |

BOTIMI

Dokumentet diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Italisë dëshmojnë se Roma interesohej ndaj kërkesave të vazhdueshme të shqiptarëve për t'u ardhur në ndihmë për armatosjen e popullatës....

1912, telegramet italiane për Shqipërinë

Fatmira Nikolli

Dokumentet diplomatike italiane për historinë e shqiptarëve kur po shpallej pavarësia i paraqiten lexuesit. Një botim i Akademisë së Studimeve Albanologjike sjell materiale nga Arkivi Historik Diplomatik i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë. "Dokumente Diplomatike Italiane për Historinë e Shqiptarëve 1912" është një botim nga Paulin Marku dhe në të gjenden dokumente që janë përgjedor, përkthyer dhe përgatitur për botim. Bëhet fjalë për telegrame, relacione dhe informacione të ndryshme të diplomatëve italianë, në të cilat evidentohet qartë këndvështrimi dhe roli që pati Italia në çështjen shqiptare gjatë vitit 1912. Këto dokumente hedhin dritë mbi një nga periudhat më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare, atë të pragut të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Materiali është i renditur kronologjikisht, bazuar në datën kur është dërguar nga përfaqësitë italiane për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë me numër dokumenti dhe protokollin, përjashtoj rastet kur nuk ekziston i vendosur në të, është dhënë vendi i nisjes së materialit, ora e dërgimit dhe e mbërritjes së telegramit, përjashtoj rastet kur orari nuk gjendet i vendosur në tekst.

1912
Ky vit ka rëndësi të veçantë për historiografinë shqiptare dhe ndjeshmëri të lartë për çdo shqiptar. Për këtë periudhë, dokumentet e huaja kanë peshë të pazëvendësueshme. "Edhe pse mund të jenë subjektive në interpretimin e disa ngjarjeve, përsëri ato kanë rol të rëndësishëm për të kuptuar qëndrimin dhe reagimin e shteteve të ndryshme ndaj çështjes shqiptare", shënon në parathënien Paulin Marku.

Ai vëren se diplomacia italiane nuk i kishte fshehur asnjëherë ambicijet për të kaluar Adriatikut dhe interesohej vazhdimisht për situatën në vilajetet shqiptare; së dyti, për faktin se ajo ishte në luftë të hapur me Perandorinë Osmane. Pra, dokumentet e paraqitura në punim plotësojnë sferën e politikës së Italisë ndaj shqiptarëve dhe Portës së Lartë. Referuar relacioneve, telegrameve dhe informatorëve që punonin për konsullatat dhe për legatat e ndryshme italiane, evidentohet se Roma i ndiqte me interes primar zhvillimet në Ballkan dhe informohej vazhdimisht për organizimin e shqiptarëve, për gjendjen e brendshme të Perandorisë Osmane, si dhe rreth qëndrimit të Fuqive të Mëdha. Marku shënon se dokumentet analizojnë situatën politike-ekonomike dhe shoqërore të shqiptarëve. Ato pasqyrojnë mënyrën se si krerët shqiptarë ranë dakord për të organizuar një kryengritje të përgjithshme në të cilën do të angazhoheshin të gjitha viset shqiptare, duke caktuar detyrat që secili prej tyre duhet t'i përmbush-

te. Kryengritja do të shpërthente në pranverë të vitit 1912 në vilajetin e Kosovës, pastaj do të shtrihet në vilajetin e Shkodrës e pastaj do të shtrihet në vilajetin e Shkodrës e kështu me radhë synohej përfshirja sa më e gjerë e të gjitha viseve shqiptare.


PAKËNAQËSIA NDAJ STAMBOLLIT

Del qartë në botim gjendja e trazuar e shqiptarëve. Pakënaqësia ndaj qeverisë së Stambollit vihej re gjerësisht, si në radhët e politikanëve shqiptarë ashtu dhe në popull, ku më të revoltuarit shfaqeshin në verilindje të Shqipërisë. Aty dallohet qartë zemërimi dhe protestat e ndryshme kundër administratës osmane. Jepen informacione për takime dhe mbledhje të ndryshme të krerëve të veriut për organizimin e të gjithë shqiptarëve në një kryengritje të përgjithshme. Sipas dokumenteve, rezultojnë se situata në vilajetin e Kosovës dhe të Shkodrës ishte më e tensionuar në pranverën e vitit 1912. Dalin në shkresë lidhjet dhe kontaktet e vazhdueshme të disa prej krerëve shqiptarë si: Ismail Qemal Beu, Hasan Prishtina, Preng Bibë Doda, Sokol Baci, Simon Doda e shumë përfaqësues të tjerë me kancelaritë e huaja. Ata kërkonin në mënyrë të vazhdueshme mbështetjen e kancelarive evropiane për kauzën e tyre dhe ndihmë financiare e armatime për kryengritjen antiosmane. "Dokumentet diplomatike të Ministrisë së Jashtme të Italisë dëshmojnë se Roma interesohej hap pas hapi për qëndrimin që mbanin Fuqitë e Mëdha dhe vendet e tjera ballkanike ndaj ngjarjeve, që zhvilloheshin në vilajetet shqiptare si dhe ndaj kërkesave të vazhdueshme të shqiptarëve për t'u ardhur në ndihmë për armatosjen e popullatës. Në dokumente pasqyrohet edhe ndikimi i klerit në komunitet dhe në çështjen shqiptare", shënon Marku.

TRAZIRAT PARË PREJ BOSFORIT

Në këtë vëllim dokumentar gjenden informacione të ndryshme rreth situatës së brendshme të Perandorisë Osmane. Sipas këtyre burimeve rezultojnë se, trazirat që po përgatiteshin të shpërtheshin në vilajetet shqiptare kishin shqetësuar jo pak Portën e Lartë dhe ajo tentoi që të parandalojë lëvizjen. Qeveria osmane dërgoi një grup ekspertësh që të vizitonin vilajetet shqiptare dhe të analizonin situatën në terren. Komisioni i reformave kryesohej nga ministri i Brendshëm, Haxhi Adil Beu dhe

Del botimi me dokumente të Arkivit Historik Diplomatik të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë



nga disa ekspertë osmanë dhe të huaj të fushave të ndryshme. Nga përmbajtja e dokumenteve dalin qartë objektivat dhe arritjet e komisionit të reformave. Udhëtimi i ministrit të Brendshëm osman nëpër vilajetet shqiptare nuk solli asnjë përmirësim pasi, në thelb, kishte qëllimin kryesor të përgatitjes së terrenit për fushatën zgjedhore të vitit 1912 në favor të Turqve të Rinj. Nuk munguan as sulmet ndaj delegacionit qeveritar. Diplomacia italiane dhe kancelaritë evropiane ishin shprehur pesimiste për suksesin e komisionit të reformave. Kishte nga ata diplomatë që e cilësonin nisimën si sipërfaqësore, sa për të qetësuar gjendjen, për të fituar kohë në mobilizimin e trupave që të shtypnin lëvizjen e armatosur të shqiptarëve. Vëllimi ka telegrame të shumta që flasin për mobilizimin e Portës së Lartë për të ndërhyrë në viset shqiptare. Po ashtu, janë disa dokumente që pasqyrojnë kërkesat e shqiptarëve ndaj qeverisë si dhe lëvizjet e krerëve shqiptarë në organizimin e kryengritjes në viset shqiptare dhe tentativat për të futur armë e muni-

cione. KUR MALËSIA E MADHE REFUZONTE ZGJEDHJET

Sipas Markut, ky vëllim dokumentar shërben për të analizuar situatën politike të kohës dhe zgjedhjet parlamentare të vitit 1912 për në Parlamentin Osman. Sipas këtyre dokumenteve, rezultojnë se një shqetësim i madh për elitën politike shqiptare ishte mënyra se si po bëhej fushata në pranverë të vitit 1912. Ata shfaqin pakënaqësi të shumta ndaj këtyre zgjedhjeve dhe akuzonin partinë "Bashkim e Përpërim" se po manipulonte zgjedhjet. Dokumentet përshkruajnë në mënyrë të detajuar fushatën elektorale të atij viti dhe objektivat e partisë së Turqve të Rinj, të cilët kërkonin me çdo kusht të fitonin zgjedhjet me rezultate maksimale. Zgjedhjet e vitit 1912 ishin mjaft të tensionuara për shkak se Turqit e Rinj bënë një fushatë të ashpër dhe arritën të marrin shumicën dërrmuese, duke lënë jashtë parlamentit disa figura të rëndësishme nacionalistësh shqiptarë. Shqiptarët i konsideruan zgjedhjet të padrejta dhe të dhunshme, çka

shtoi zemërimin e tyre ndaj xhon-turqve në pushtet. Malësorët e Malësisë së Madhe deklaruan se nuk do të merrnin pjesë në votim nëse nuk plotësoheshin kërkesat e tyre në lidhje me kandidaturën për deputet. Kjo nuk i frenoi xhon-turqit në realizimin e objektivit politik, ku arritën të fitojnë mazhorancën parlamentare.

KUR MALI I ZI NDALONTE KRYENGRITJEN

Ashtu si Perandoria Austro-Hungareze edhe Mbretëria e Italisë ishte për ruajtjen e status-quo-së. Megjithatë Vjena zyrtare, ndërhyri herë pas here tek Porta e Lartë për çështjen shqiptare, ajo nuk arriti të ndalojë kryengritjen e vitit 1912. Mali i Zi kishte ndikim tek krerët e Malësisë së Madhe dhe u përpoq të përfitojë nga situata për të shtrirë influencën e tij për shkak se shqiptarët ia kishin nevojën për të futur armë nëpërmjet territorit malazez, Mbreti Nikolla ishte kundër përfshirjes së malësorëve të Malësisë së Madhe në kryengritjen që do të shpërthente në Kosovë. Ai u përpoq që t'i frenonte ata dhe u sugjeronte vazhdimisht krerëve të tyre që të distancoheshin nga lëvizja që shpërtheu në pranverë të vitit 1912 në vilajetin e Kosovës. Pasi vizitoi Shën Peterburgun qëndrimi i tij u bë publik edhe para autoriteteve osmane në Mal të Zi sepse Mbreti Nikolla i ishte sugjeruar nga Rusia që të distancohej nga këto lëvizje. Dokumentet e botuara dëshmojnë se Italia, nën hije, rivalizojte Vjenën dhe përpiqej të informohej në mënyrë të detajuar për gjendjen në vilajetet shqiptare. Roma kishte informacione të bollshme për organizimin e brendshëm dhe të jashtëm të krerëve shqiptarë në kryengritje si dhe rreth kancelarive evropiane. Gjenden në libër një numër i madh relacionesh dhe telegramesh që dërgoheshin nga ambasada, legata e konsullata italiane për Ministrinë e Punëve të Jashtme të Italisë dhe një numër i pakët i dërguar nga kryediplomati San Giuliano për të udhëzuar diplomatët rreth qëndrimit që po ndiqte politika e jashtme italiane ndaj kryengritjes së vitit 1912. Dokumentet pasqyrojnë qartë qëndrimin e qeverisë austro-hungareze, ndërhyrjet e saj tek Porta e Lartë për të mbrojtur të drejtat e shqiptarëve dhe këshillat paqësore të saj për ruajtjen e status-quo-së. Ndër të tjera, në dokumente pohohet se Perandoria Dualiste gëzonte simpati dhe besim tek shqiptarët, kryesisht të besimit katolik, se ishte e pranishme në çështjen shqiptare dhe me ndikim në radhët e elitës politike.

"EUROVISION"

Bëhen publikë emrat e jurisë shqiptare në Eurovision

Shqipëria do të përfaqësohet këtë vit në festivalin më të rëndësishëm të muzikës europiane "Eurovision" me këngëtarja Jonida Maliqi dhe këngën e saj "Ktheju Tokës". Ndërkaq, secili shtet pjesëmarrës në konkursin ndërkombëtar të këngës ka edhe një juri që vlerëson këngët e festivalit evropian. Këngëtarja Anxhela Peristeri ka treguar për ndjekësit e saj në rrjetin social "Instagram" krahas faktit se ajo do të jetë pjesë e kësaj jurie, edhe emrat e pjesëmarrësve të tjerë. Juria shqiptare duket se do të ketë pjesë të saj edhe Eranda Libohovën, Dilan Rekën, Julka Gramon dhe Gent Rushin. Jonida Maliqi u përzgjedh si përfaqësuesja e cila do të përfaqësojë vendin në Izrael, pasi u shpall fituese e festivalit të 57 të RTSH-së. Këngëtarja fitoi 228 pikë nga juria. Në datën 16 maj, Maliqi pritet të përfaqësojë Shqipërinë në festivalin e përvitshëm të "Eurovision" me këngën fituese të festivalit të "RTSH", "Ktheju Tokës". Kënga është pëlqyer shumë nga të gjithë ndjekësit e këngëtares jo vetëm brenda trojeve shqiptare, por edhe jashtë saj. Në udhëtimet e shumta që Maliqi ka zhvilluar këto kohë, ka zbuluar reagimet fantastike të të gjithë adhuruesve të këngës përfaqësuese në festival. Në fundmi "Ktheju Tokës" ka arritur 1 milionë klikime në kanalën e "Youtube", duke u renditur kështu si kënga e parë shqiptare më e klikuar para netëve të gjysmëfinale. Kujtojmë se deri më tani kënga është realizuar në "cover" nga adhurues të ndryshëm të muzikës në mbarë

Jonida Maliqi thyen rekordin e klikimeve me këngën "Ktheju Tokës"



botën, duke treguar dhe njëherë suksesin që ka pasur. Po ashtu në një sondazh të bërë pak ditë më parë, "Ktheju Tokës" u klasifikua si kënga më e pëlqyer në "Eurovision 2019".

KLIP

Një vrap për t'i ikur frikës, duke kthyer herë pas herë kokën pas, por duke kërkuar shpëtim. Lexon

në hapat që hidhen me nxitim ankthin të ikur në mesnatë pa parë se ku po i hedhin këmbët. Derisa një shi i madh, duket se lan gjithë baltën që e shkelëm kur ecim në errësirë. Të gjuhëzuar që mezi ngrihen në këmbë, trupa që shquhen po nuk shihen. E kanë lënë folën si në legjendën e shqiponjës. "Është kjo foleja e një shqiponje,



JONIDA MALIQI - KTHEJU TOKËS

por që me këtë simbolikë autorët duan ta përgjithësojnë atë me folenë, apo shtëpinë e gjithkujt. Dhe foleja e çdo shqiptari, është Shqipëria. Kur folenë e prishin, e djezin dhe kur gjendesh mes flakësh, t'i mundohesh të gesh shpëtim, t'i shpëtimi është ikja. Ti ikën, por gjithçka mbetet aty: zanafilla, gjaku, origjina, identiteti e çdo gjë tjetër që të personifikon. Ti ikën, por brenda vetes lufton me dëshirën dhe klithmën e kthimit... Ktheju ideja që përcjell videoklipin i këngës së Jonida Maliqit, "Ktheju tokës", me të cilën përfaqësohet Shqipëria në Eurosong.

Me muzikë dhe tekst të Eriona Rushtitit dhe aranzhim muzikor të Enis Mullaj, ky klip vjen i realizuar nga Triangle Studios. Regjisori

Genc Gjineci dhe Andi Kotri e kanë ngritur idenë e klipit mbi simbolin e folesë, sepse mesazhi i këngës vjen i përcjellë nëpërmjet folesë së shqiponjës, ujit dhe zjarrit! Fustani që vesh Maliqi është i stilistit Ardi Asllani dhe ruan të njëjtën ide që ka klipi: tokën, folenë dhe vendin amë. Kënga interpretohet në gjuhën shqipe si në klip edhe në skenën e Eurovisionit, në Tel Aviv të Izraelit. Prej ditës kur u shpall fituese e Festivalit të Këngës në RTSH, vëmendja tashmë është drejtuar nga Maliqi. Këngës i janë bërë edhe covera. Kënga "Ktheju tokës" doli fituese e Festivalit të 57-t të Këngës në Radio Televizionin Publik Shqiptar dhe konkurron në datë 16 maj në Eurovision 2019. Në javët në vijim nis nëpër Europë edhe turi promovues i këngës.

"PARULLAT ME GURË" TË YLLJET ALIÇKËS, NË GJUHËN GJERMANE

Krahas historive të thjeshta të vendit të tij, Shqipërisë, nën regjimin Stalinist të Enver Hoxhës, në tregimet e tij, autori përshkruan ndodhi, po aq absurd të tranzicionit postkomunist". Ky është shënimi që shoqëron botimin e në gjuhën gjermane të përmbledhjes së njohur të shkrimtarit Ylljet Aliçka "Parullat me gurë". I përkthyer nga Edmond Ludwig dhe botuar nga shtëpia botuese MAS, me rastin e këtij botimi botuesi gjerman ka vënë edhe shënimin e mësipërm. Ndërsa më herët, "Le Monde" vërente "Si përgjatë makthit të partisë, ashtu edhe nën anarkinë liberale që e zëvendësoi atë, mbetet e njëjta shpërbërje morale që i zhvlerëson personazhet e Aliçkës... Absurdi me të gjitha format e tij që të çon tinëzisht drejt poshtësisë". Ndërsa dikush i

ka lexuar 'Parullat me gurë' si bartëse të një fryme oruelliane, ato shihen edhe si një kujtesë nga e kaluara dhe një paralajmërim për ato shoqëri ku rritet kontrolli i qeverisë ndaj gjuhës. Mesazhi i Aliçkës na kujton se, nëse do të ndërtohet nga propaganda, kemi humbur veten tonë. Disa vite më parë pas botimit të këtij libri në polonisht, shkrimtari i njohur polak Ryszard Kapuściński ndër të tjera ka shkruar "...i lexova me emocion dhe konsideratë të lartë, fjala është për disa tregime të shkurtra të një letërsie të madhe." Varianti gjerman i parullave të Aliçkës, pason botimet e këtij libri në frëngjisht, italisht, çekisht, anglisht dhe polonisht si dhe filmën e mirënjohur të regjisorit Gjergj Xhuvani "Slogans", me skenar të autorit vetë autorit të parullave.

Festivali ndërkombëtar i filmit DEA OPEN AIR në pesë edicionet e fundit e ka krijuar emër në botën e kinemasë. Në ekranin e tij kanë zënë vend filmat të ndryshëm të industrisë europiane të kinemasë. E gjithë kjo prurje kishte nevojë edhe për një zgjerim gjeografik të pranisë së tij thonë organizatorët ndaj DEA OPEN AIR - në vitin/edicionin e vet të gjashtë vjen edhe në Tiranë në datat 2-8 maj. Përmes një njoftimi për mediat, organizatorët thonë se Tiranë si një metropol modern ofron të gjitha mundësitë për realizimin e synimit të organizatorëve, për ta bërë Tiranën - përkrah Sarajevos dhe Selanikut - qendër të rëndësishme të takimit të kineastëve, producentëve dhe kryesisht të

distributorëve të industrisë së filmit.

"Kryeqyteti, me burimet e veta njerëzore, infrastrukturën gjithnjë në modernizim, pozitën gjeografike, klimën, mikropitjen, peizazhin e mrekullueshëm, atraksionet e shumëfishta kulturore, afërsinë me Malin e Dajtit, Durrësin, Krujën, Beratit apo Apolloninë, ofron mundësi të rralla të turizmit edhe kulturor, duke disponuar të gjitha mundësitë për të jetë atraksion për kineastët e huaj".

Tiranë me sheshin Skënderbej, amfiteatrin dhe mjediset e Universitetit të Arteve dhe Pazarin e Ri ofrojnë hapësira për zhvillimin e një festivali cilësor e popullor. Festivali do t'i qëndrojë konceptit OPEN AIR. Kinemaja kryesore për ofrimin e programit të Filmit Artistik me Metrazh të Plotë do të jetë Amfiteatri i Uni-

versitetit të Arteve, së cilës i shtohen edhe Salla qendrore e Universitetit të Arteve, Salla Blak Box1 dhe Blak Box2. Arena e Festivalit do të jetë në sheshin përpara Universitetit të Arteve, ku do të ngrihet çadra e festivalit, ku do të zhvillohen çdo ditë konferencat e shtypit si dhe çadrat e ofertës kulturore (Bashkia Tiranë), projekteve dhe promocionit të institucioneve dhe mbështetësve të tjerë të festivalit. Programi do të ofrohet edhe në dy kinema të improvizuara në formë shfaqjesh publike për banorët e Tiranës: në kinemanë e madhe DEA OPEN AIR në sheshin "Skënderbej" dhe në kinemanë e improvizuar DEA OPEN AIR te Pazarin e Ri.

"DEA OPEN AIR" FESTIVALI I SARANDËS VJEN NË TIRANË

Opinion i Ditës

"Topi" i negociatave në portën tonë!

Nga Jorgji Kote

(vijon nga faqja 1)

... lidhur me anëtarësimin tonë në BE nuk mund të flitej, pasi ende nuk ka dalë raporti i Komisionit Evropian me rekomandimin përkatës. Veç kësaj, për arsye të njohura, Presidenti Macron nuk pranon që emri "zgjërim në Ballkan" të përmendet të paktën deri në përfundim të zgjedhjeve evropiane të 23-26 majit. Shkak tjetër kryesor pse në Berlin nuk mund të flitej në terma konkretë ishte se sipas disa burimeve të besueshme, do të jetë tejet e vështirë, për të mos thënë e pamundur që në qershor të ketë një vendim për çeljen e tyre. Kjo mund të ndodhë me shumë gjasa në shtator/tetor.

Larg politizimeve dhe akuzave politike e partiake, me avantazhin si ish-diplomat me përvojë të gjatë në Bruksel deri kohët e fundit, le ta shohim këtë aspekt nga ana praktike.

Mosmarrja e vendimit të shumëpritur këtë qershor, me përjashtim të ndonjë mrekullie politike, si psh., fitore të forcave tradicionale në zgjedhjet evropiane ka të bëjë me pamundësinë praktike dhe organizative të vendeve anëtare të BE-së, për shkak të procedurave që nuk lëvizin "sikur nami të bëhet".

Fillimisht, Komisioni Evropian do të publikojë Raportin e tij të Progresit me rekomandimin për negociatat më 29 maj. Mirëpo, periudha e mbetur prej gati tri javësh deri në takimin e Ministrave të Jashtëm e pastaj të Këshillit Evropian në qershor është shumë e shkurtër për shqyrtimin e tij në instancat përkatëse qeveritare të çdo vendi anëtar. Por, puna nuk mbaron me atë; në vijim, opinioni i secilit vend, sidomos i atyre skeptike do të kalojë për shqyrtim në komisionet përkatëse dhe në seancën plenare të Parlamentit të tyre; shtu këtu dhe klimën politike pas zgjedhjeve evropiane, me pasojat e tyre, sidomos nëse rezultatet e tij do të jenë zhgënjyese për forcat tradicionale pro-evropiane. Për pasojë, dhe në rastin më të mirë, do të jetë tejet e vështirë për këto parlamente, ku asnjë parti nuk ka shumicën që të dalin me një vendim përpara vjeshtës, duke pasur parasysh edhe axhendat e ngarkuara në prag të pushimeve verore.

Vetëm pas kësaj, opinioni i secilit vend anëtar do të përcillet për shqyrtim të mëtejshëm në forumet përkatëse të BE-së në Bruksel, duke filluar nga Grupi i Punës i Ballkanit Perëndimor (COE) deri të Këshilli i Ambasadorëve të Vendeve Anëtare të BE-së (COREPER); mbi këtë bazë jepen rekomandimet për ministrat e Jashtëm e këta të fundit Këshillit Evropian për vendimim përfundimtar.

Kësisoj dhe në kushte normale, vendimi i Këshillit Evropian për çeljen e negociatave mund të jepet duke filluar nga muaji shtator. Veçse këtu nuk ka kurrfarë drama;



është normale një shtyrje disamujore, kur në fakt kemi humbur dy dekada për faj të klasave tona politike. E rëndësishme është që edhe në këtë rast, negociatat mund të çelen brenda këtij viti ose maksimumi në tremujorin e parë 2020, në prag dhe të Samitit të Zagrebit. Ndaj, sfida më e madhe tani nuk është kjo shtyrje fare e vogël kohore, por që vendimi në fjalë të bëhet realitet. E themi këtë, për shkak të disa problemeve dhe pengesave serioze, të jashtme dhe të brendshme, mostrajtimi i efektiv i të cilave mund ta zgjatë edhe më tej çeljen e tyre, kryesisht për fajin tonë.

Faktori i jashtëm kryesor e që nuk varet prej nesh është klima dhe rezultati i zgjedhjeve evropiane, sidomos për Francën, Holandën, Danimarkën, Gjermaninë e ndonjë tjetër, të cilat janë vendimtare për çeljen e negociatave. Këtu nuk është thjesht çështje shifra statistikore, por mbi të gjitha ndjeshmëri dhe perceptimesh për vendet anëtare dhe elektoratet e tyre. Të mos harrojmë se krahas Komisionit dhe Parlamentit Evropian, BE-ja përfshin, madje në radhë të parë të 27 vendet anëtare; madje këto të fundit kanë dalë edhe më në pah këto kohët e fundit; së shpejti, prirja "ndërqeveritare" në BE pritet të mbizotërojë atë "supranacionale".

Ndaj, kërkohet kujdes kur i fryhet më tepër se ç'duhet propagandës me Komisionin dhe Parlamentin Evropian e ca më keq me protagonistë pa ndonjë peshë të ndjeshme në elektorate, me gjithë rëndësinë e tyre. Por, edhe në diferencimet lidhur me qëndrimet e vendeve anëtare kërkohet kujdes nga politikanët, sepse vërtet ka segmente dhe forca politike që na mbështetin, por ka edhe të tjera që janë kundër dhe mezi presin "të

hakmerren". Për fat të keq, edhe partitë "simotra" socialiste të mazhorancës sonë janë në pushtet vetëm në pesë vende anëtare, madje edhe aty në pakicë, përfshirë edhe SPD-në, Gjermaninë me problemet e veta, ndërsa në Francë, Greqi, Holandë dhe Danimarkë kanë peshë minimale në vendim-marrje.

Megjithatë, qëndrimet e shteteve apo grupeve të caktuara skeptike ndaj nesh nuk ndryshojnë, duke i anatemuar e stigmatizuar, apo duke i bërë karshillëk, por vetëm me punë e përpjekje më të mëdha nga ana jonë, me qëllim që edhe gjatë këtyre pak muajve e më tej të ndryshojë sadopak për mirë imazhin dhe perceptimin e tyre ndaj nesh, që edhe pse ka raste kur nuk i përgjigjen realitetit dhe shifrave, janë sërish vendimtare në këtë proces.

Vijmë kështu te fronti ynë i brendshëm me sfidat e tij madhore. Veç aspekteve të tjera të përmendura në Berlin, Shqipëria po ballafaqohet me dy kriza serioze dhe kritike për fatin e çeljes së negociatave. Është djegia e mandateve parlamentare të opozitës tradicionale, e shoqëruar me protesta nëpër sheshe dhe rrugë, acarimi i të cilës mund të kthejë mbrapsht edhe arrijtet e deritanishme, duke shtyrë në kalendat greke dhe anëtarësimin tonë në BE. Ndërkohë, po na trokasin te porta zgjedhjet lokale të 30 qershorit, që edhe në situata normale do të kishin ndikimin e tyre për çeljen e negociatave, e ca më tepër me problematikën e tyre të nxehtë. Mirëpo edhe zhvillimi i tyre sado i mirë pa opozitën tradicionale, le më pastaj me variantet më të këqija të mundshme, do të kompromentonte edhe më rëndë dialogun pozitë-opozitë dhe parimin e zgjedhjeve të lira e të ndershme. Dihet se këto dy të

fundit janë kushte dhe kriteret jetike për negociatat dhe të gjithë procesin e anëtarësimin në BE.

Veç sa sipër, ekziston mundësia që këto dy kriza konfliktuale me pasojat e tyre të shfrytëzohen dhe nga ndonjë vend i caktuar anëtar i BE-së, që me "elegancë" të heqë dorë nga pretendimet e mëparshme dhe të tregojë gishtin pikërisht te problematika ulëritëse e këtyre dy komponentëve jetikë të demokracisë te ne.

Po qëndrimet tona rajonale, sidomos lidhur me dialogun Serbi-Kosovë dhe modistancimi ynë zyrtar ndaj tezës ogurze të ndryshimit/këmbimit të kufirit? A e parë që në Berlin nuk na përmendën më si më parë për mirë për qëndrimet tona të moderuara dhe konstruktive rajonale; kjo edhe për shkak të pohimeve/ deklaramëve tona të bujshme të tipit nacionalist, që vetëm se i ngatërrojnë më shumë punët. Këto janë minuse politike dhe diplomatike që mund e duhet të kthehen sa më parë në plusë pozitive.

Ja përse në këto kushte, gjatë muajit shtator, por edhe më tej, krahas punës dhe demarshëve me institucionet evropiane, vëmendja kryesore e politikës, Parlamentit, Kryeministrit, Presidencës dhe diplomacisë sonë zyrtare lipset të fokusohet te organizimi i një fushate të fuqishme me ture lobuese në vendet skeptike ose të lëkundura, veçanërisht me parlamentet dhe mediat e tyre, veçse pa zhurme, kujë e bujë. Krahas mesazheve të qarta dhe pozitive nga Presidencia e Kuvendi, kërkohet në radhë të parë intensifikimi i diplomacisë parlamentare, sidomos i grupeve të miqësisë me vendet përkatëse, duke filluar nga Holanda; së bashku me burimet dhe kapacitetet tona të shumta të diplomacisë publike, kulturore dhe

qytetare jashtë vendit. Të shoqëruara doemos me rezultate konkrete në reformat në fushat e drejtësisë, rendit, sigurisë, luftën kundër krimit e korrupsionit etj.

Tejet e rëndësishme në këtë drejtim është gjuha e kulturuar dhe diplomatike e politikanëve dhe drejtuesve tanë. Etiketimet, stigmatizimet dhe fajësimi i të tjerëve për gjynahet tona janë kundraproduktive dhe vetëm se e vështirësojnë më shumë problem-in. Nëse duan vërtet çeljen e negociatave, drejtuesit tanë më të lartë duhet të tregohen më kokulur, më modestë dhe me "këmbë në tokë", pa u dhënë mend të tjerëve, sepse jemi "ende në radë", gjithashtu të shprehemi me gjuhë pozitive, duke kërkuar në radhë të parë nga vetja e pastaj nga të tjerët. Natyrisht, sugjerimet dhe rezervat që mund të kemi ndaj gjithkujt duhet t'i shprehim, por në kanalet dhe mënyrat e duhura diplomatike, duke shprehur ndërkohë edhe mirëkuptimin tonë për problemet dhe vështirësitë e të tjerëve; ashtu si kanë vepruar edhe ata me ne këto tri dekadat e fundit, edhe kur "ua kemi sjellë në majë të hundës". Gjuha, deklaratimet dhe sjellja politike/diplomatike ndaj Holandës tani së fundi, një prej bashkëthemeluesve të BE-së dhe mbështetëse e fuqishme e vendit tonë është shembulli më i qartë se si nuk duhet të sillemi me partnerët tanë evropianë. Bismarku i hekur këshillonte politikantët që "sillu mirë, shkruaj në mënyrë diplomatike, se edhe në një deklaratë lufte respektohen rregullat e mirësjelljes".

Sic është përmendur edhe më parë, me gjithë mungesat dhe mangësitë, jo të gjitha për faj të saj, Ministria e Jashtëm dhe përfaqësitë tona diplomatike, e sidomos ambasada dhe misioni ynë pranë BE-së në Bruksel kanë qenë në lartësinë e detyrave të ngarkuara. Ndiham dhe mbështetja ndaj tyre, pa lenë pas dore për shkak të pohimeve/ deklaramëve tona të bujshme të tipit nacionalist, që vetëm se i ngatërrojnë më shumë punët. Këto janë minuse politike dhe diplomatike që mund e duhet të kthehen sa më parë në plusë pozitive.

Ja përse në këto kushte, gjatë muajit shtator, por edhe më tej, krahas punës dhe demarshëve me institucionet evropiane, vëmendja kryesore e politikës, Parlamentit, Kryeministrit, Presidencës dhe diplomacisë sonë zyrtare lipset të fokusohet te organizimi i një fushate të fuqishme me ture lobuese në vendet skeptike ose të lëkundura, veçanërisht me parlamentet dhe mediat e tyre, veçse pa zhurme, kujë e bujë. Krahas mesazheve të qarta dhe pozitive nga Presidencia e Kuvendi, kërkohet në radhë të parë intensifikimi i diplomacisë parlamentare, sidomos i grupeve të miqësisë me vendet përkatëse, duke filluar nga Holanda; së bashku me burimet dhe kapacitetet tona të shumta të diplomacisë publike, kulturore dhe

Opinioni **i** Ditës

Pranvera djegëse e një kryeministri

Nga BARDH SPAHIA

(vijon nga faja 1)

... e procesit të iniciuar nga Kancelarja në gusht të vitit 2014, Edi Rama jo vetëm që nuk kishte një bilanc për detyrat e shtëpisë që Merkel ia kishte përsëritur disa herë edhe publikisht, por i dha një tjetër provë asaj, se deri ku arrin një individ me pushtet, me delirin për t'u bërë faktor në marrëdhënien Kosovë-Serbi, me një lojë të errët gjeopolitike, jo vetëm për rajonin.

Nëse nuk do ishte për kancelaren, kryeministri i Shqipërisë me flirtet e rrezikshme për shkëmbim kufijsh për egon e vet të sëmure, do shndërrohej edhe në fatkeqësinë e Kosovës, siç ka bërë me qytetarët e vet.

Pa një bilanc në luftën kundër krimit e korrupsionit, me raste të shtuara të abuzimit me paratë publike dhe një krizë politike e institucionale në vend, kryeministri që tashmë e ka të qartë se ka thyer besimin e çdo ndërkombëtarit me peshë në vendimmarrjen europiane, nuk arriti të gjente as edhe një frazë pozitive për të nga takimi me Kancelaren, që t'i servirte shqiptarëve. Po shpreson të njëjtin skenar si para një viti, kur Shqipëria tërhoqi pas vetes Maqedoninë në refuzimin që mori për hapjen e negociatave. Ëndërron përsëritjen e historisë e për arsye gjeopolitike, të jetë Maqedonia e Veriut ajo që me kushte të plotësuara, të tërheqë edhe Shqipërinë në "po" në BE. Përtej ankthit të kryeministrit Zaev në Berlin, identifikimi nga mikpritësit e Samitit të marrëveshjes së Prespës si një model suksesi që duhet të ndiqet nga Kosova e Serbia, është sinjali paraprak i përgjigjes pozitive për Shkupin në shtator nga Këshilli Europian. "Të flasim singjerisht së bashku", u tha Angela Merkel pjesëmarrësve në Samit. Në krye të të pasinqertëve kryeministri i Shqipërisë, që për hir të karriges së vet, po e thellon krizën politike, kushtetuese e të përfaqësimit në vend.

Djegia e mandateve, një sakrificë aspak e vogël e opozitës, e ka padyshim anën e mirë: po zbulon ditë pas dite degradimin e një kryeministri të sëmure për pushtet. Pasi nuk pati asnjë skrupull për blerjen e votave, ishte radha e paralizimit të sistemit të drejtësisë, që i përgjigjet vetëm komandave të kryeministrit, e paralizimit të gjykatave të epërme, që mund të frenonin abuzimin sistematik, njëllor si hetimet për vjedhjen e votave për llogari të socialistëve, të paktën aty ku ka çështje, në Durrës e Dibër.

Një kryeministri që guxon të trajtojë edhe vendin si Partinë So-



cialiste, në mënyrë të pabërgjegjshme luan skenaristin e regjisorin, së pari, në institucionin që duhet të kontrollojë e monitorojë ekzekutivin, parlamentin. Tempullin e përfaqësuesve të popullit e ka kthyer në skenën personale ku cakton rolet e opozitës, duke e futur në një krizë të thellë përfaqësimi institucionin bazë të republikës sonë parlamentare. Skenari vijon edhe për zgjedhjet, aty ku ka ndarë rolet për të tjera parti e individë, me të cilët pretendon të luajë opozitën e të mbajë zgjedhje pa të. Qytetarëve që protestojnë krah opozitës kundër tij, u tregon prangat e burgun ndërsa policia e shtetit është nën drejtim militantesk, të niveleve të paarritura më parë.

Por, sado të anatemojë opozitën, të shpikë fajtorë e armiq ngado rreth tij, faktet janë kokëforta. Në gjashtë vjet Edi Rama e ktheu shtetin në një fasadë, që ra plotësisht në sytë e shqiptarëve me djegien e mandateve të opozitës, pasi secili mund të shohë individin që ka marrë peng vendin, duke kontrolluar e abuzuar me çdo pushtet, ndërsa një ushtri virtuale që paguhet me taksat e shqiptarëve, mbron në rrjetet sociale kryeministrin dhe beniaminën të caktuar të tij kundër denoncimeve e pasur kënaqësisë që vjen edhe nga vetë të majtët. Me shtetin fasadë pretendon të ndjekë shembullin e diktatorit e të garojë me vetveten në

zgjedhje. Mjerisht 30 vjet pas rrezimit të diktaturës, si kurrë më parë në gjashtë vitet e fundit, reliket e komunizmit që falë edhe indiferencës sonë, kanë përfutur funksione publike e jo vetëm, po riaktivizohen duke guxuar të sulmojnë këdo që evidenton krimet e një regjimi, që burgosi e internoi qytetarët e vet, dhe e shndërroi Shqipërinë në një kamp të izoluar prej 28 mijë km katrorë. Është një kambanë alarmi se e keqja që vjen nga ky kryeministër është edhe më e thellë, pasi nën qeverisjen e tij, agresorët e diktaturës, aktorë në vetë të parë apo pasardhës, po sulmojnë viktimat, duke na kujtuar të gjithëve se i kemi ende një borxh të rëndësishëm vendit, pasi nuk kemi sistemuar kapitullin tejte të kushtetueshmë të 46 viteve diktature. Izolimi duket se po rikthehet pasi prej 2014-ës, kur si vazhdim i përpjekjeve të qeverisë Berisha, Shqipëria mori statusin e vendit kandidat në BE, nuk ka asnjë lloj avancimi nën qeverinë Rama. Madje rrezikojmë një kthim pas, me kërkesën unike që merr Komisioni Europian për heqjen e vizave për Shqipërinë nga një vend themelues i BE si Holanda. Kryeministri vazhdon të shikojë armiq gjithandej, por fakt është se nuk mbahet mend kur ka pasur takimin e fundit zyrtar dy palësh me një homolog europian, sepse Edi Ramën askush as nuk e pret, e as nuk e viziton më prej

kohësh. Kjo qasje ndaj kryeministrit padyshim është një lajm i keq për shqiptarët, por duhet të jetë një nxitje që secili të kuptojë se ky kryeministër që flet e sillet në emrin tonë, nuk na përfaqëson më, por është thjesht kosto për vendin! Secili e dallon po ashtu mirë se Shqipëria është më keq se një vit më parë, e përkeqësimi po ndodh vit pas viti prej gjashtë viteve.

Stabiliteti fals që deri tani ka mjaftuar në parim nga ndërkombëtarët edhe në rajon, jo vetëm në vendin tonë, dukshëm nuk do mjaftojë më, e prandaj Gjermania e Franca kanë marrë rolin kryesor për monitorimin e zhvillimeve në Ballkanin Perëndimor, duke i dhënë së pari fund delireve për rishikim kufijsh mes Kosovës e Serbisë, të cilat venë në pikëpyetje paqësisht atë që Kosova e ka fituar prej 11 viteve, pavarësinë. Askush nuk mund të bëhet zot në shtëpinë e tjetrit e askush nuk mund të trajtojë vendin e vet si çifligun personal. Përballë arrisancës së kryeministrit, koha është për të çliruar vendin nga pengmarrja e një njeriu të vetëm. Pranvera është dëshmuar stina tradicionale e ndryshimeve politike në jo pak vende, e vetë Shqipëria e ka provuar në pranverën e vitit 1992. Koha është për një ndryshim po aq të madh.

HOROSKOPI

DASHI

Është digja e mrekullueshme që ju keni një qëllim të ri dhe jeni ju këshillojnë që të punoni mbi këtë qëllim sa më shpejt që të jetë e mundur, nëse doni ta arrini atë. Për të marrë ndihmën që ju nevojitet, jeni disa njerëz të ngjashëm, me të cilët ndani shpresat dhe ëndrrat tuaja.

DEMI

Njerëzit të cilët keni zgjedhur për të përfshirë në jetën tuaj janë aty me dëshirën e tyre. Jeni me fat që threhoheni nga njerëz, të cilët ju duan dhe ju vlerësojnë. Mos e merrni për të mirëqenë këtë, por tregoni mirënjohje me vepra konkrete ndaj tyre.

BINJAKET

Ju mund të jeni shumë të ndikuar nga idetë e reja që po lundrojnë rreth jush, por kjo nuk do të thotë se jeni lehtësisht të manipulueshëm. Tani për tani mendja juaj është e hapur për mënyra të reja të të vepruarit, veçanërisht në dashuri.

GAFORJA

Ju keni shumë punë të mëdha përpara dhe pa shumë përpjekje do të jetë e vështirë që të arrini rezultatet që do të donit. Sot gjithashtu mund të përfshihen në një debat të zjarrtë, në një vend ku nuk e prisnit të ndodhte kjo.

LUANI

Jini të durueshëm, edhe nëse një ftesë të cilën e prisni prej kohësh nuk po ju vjen. Ka gjithmonë një arsye pse gjërat nuk ndodhin dhe jo gjithmonë arrini t'i kuptoni. Sa i përket dashurisë, ndjeni nevojën e një personi që ta keni pranë.

VIRGJERESHA

Premtimi i pambajtur i një miqut të ngushtë është ende ju ka lënë një shije të keqe, kështu që një angazhim shoqëror me të mund të jetë pak më stresues se zakonisht. Mundohuni të jeni të hapur për këtë dhe t'i thoni gjërat siç i ndjeni, por gjithmonë me një dozë të fortë kujdesi.

PESHORJA

Sot ju do të takoni dikë që sjell shumë humor në jetën tuaj. Ky person mund të jetë gati për një romancë me ju! U habitet? Mendojni një herë se ndoshta gjërat mund t'ju dalin për mbarë në këtë drejtim.

AKREPI

Nuk ka asgjë të keqe ta trajtosh vetëm me komplimente herë pas here. Të qenit gjithmonë modest mund të krijojë përshtypjen e gabuar tek njerëzit me të cilët bashkëpunoni. Mos u tregoni gjykatës i pashpirt ndaj vetes.

SHIGJETARI

Sot mund të krijoni lidhje me njerëz, të cilët më parë i kishit menduar se nuk kanë asgjë të përbashkët me ju. Kjo është e bukura, sepse kur u jepni kohë njerëzve që të shprehen, atëherë arrini t'i kuptoni më mirë.

BRICJAPI

Kur bëhet fjalë për financa, nuk mund të lejoni që reputacionin tuaj të vendoset para logarisë suaj bankare. Nëse keni frikë se mund të hakeni koprac, duhet ta tejkaloni këtë frikë. Përpuni të vendosni interesat tuaja para të tjerëve.

UJORI

Trajtojini kolegët me respekt edhe nëse keni të bëni me njerëz, të cilët nuk ju lënë përshtypje të mirë. Në dashuri tregoni më shumë angazhim ndaj partnerit, ndryshe mund të përfshihen në disa tensione.

PESHQIT

Kohët e fundit po kaloni momente stresuese në punë, por duhet t'i kaloni ato me pak humor. Kjo do të nxisë energjinë pozitive dhe do të përmirësojë gjendjen tuaj të brendshme. Në dashuri, situata duhet shumë e qëndrueshme.

E KONFIRMON UEFA



Ndeshja kundër Moldavisë, në program për në 11 qershor, ishte afati i vendosur nga Federata Shqiptare e Futbollit për përzgjedhjen e stadiut të ri "Arena Kombëtare". Por, për të parë skuadrën kuqezi të luajë në impiantin e ri duhet pritur akoma më gjatë. Një konfirmim për këtë vjen nga UEFA. Në axhendën e sfidave për eliminatorët e "Euro

"Arena Kombëtare" nuk do të përrurohet me Moldavinë

2020", qeveria europiane e futbollit tregon se përballja mes Shqipërisë dhe Moldavisë do të zhvillohet në stadiumin "Elbasan Arena". Ndoshta në Federatën Shqiptare të Futbollit vazhdojnë të besojnë se "Arena

Kombëtare" do të jetë gati në afatin e përcaktuar më parë, pasi në adresën zyrtare të saj mbetet ende në fuqi ky stadium si fusha pritëse e ndeshjes së 11 qershorit. Deri në këtë ditë mbetet pak më shumë se një muaj, ndër-

sa punimet në impiantin e ri kanë hyrë në një tjetër stad. Pas montimit të impiantit elektrik të ndriçimit, tani ka filluar puna për dranzhimin e fushës, që i hap rrugë vënies së tapetit jeshil. Aktualisht po punohet me ritme të larta, por duhet parë nëse do të arrihet objektivi i FSHF-së, që ta ketë stadiumin gati pas 41 ditësh.



Jeton Selimi

Të kuqtë kanë një dëshirë të madhe, por më parë duhet të mundin Flamurtarin

Partizani bën llogaritë, festën e madhe e do në derbi

FSHF-ja, në ankth për javën e 32-të, sjell gjyqtarë të huaj

Në shtëpinë e kuqe gjithçka rrotullohet rreth titullit kampion, tifozët ëndërrjnë skenarin më të bukur të mundshëm, të festojnë titullin pikërisht në derbin e kryeqytetit. Me Kukësin që ka tri pikët në tavolinë këtë javë, topi kalon te Partizani. Kalendar i rezervon ekipit kryeqytetas Flamurtarin, një kundërshtar delikat, një transfertë që gjithnjë ka qenë e vështirë. Në vizitën e fundit që ka bërë në Vlorë, Partizani është mundur me rezultatin minimal 1-0. Pas humbjes kundër Skënderbeut në transfertë, vlonjatët do të kërkojnë të rikthehen te fitorja, një treqësh do të mbante në vendin e tretë. Kjo është një sfidë e veçantë edhe për Ilir Dajën. Pavarësisht se u largua nga Tirana në mënyrë jo të hijshme, për Dajën sfida kundër Partizanit mbetet gjithnjë një derbi. Si rrallëherë këtë periudhë, Partizani vjen në kushte optimale në këtë ndeshje, rikthehen dy lojtarët e pezulluar, Atanda dhe Rexhepi, ndërsa mungesa e sigurt është ajo e Bruno Telushit. Pas Flamurtarit, Partizani do të presë Tiranën në derbi, dy lojtarë në veçanti duhet të bëjnë kujdes për të mos munguar në sfidën më të rëndësishme të futbollit shqiptar, Jaser Asani dhe Ardit



Hila, nëse do të ndëshkohen sërish humbasin përballjen me Tiranën.

FSHF-JA SJELL GJYQTARË TË HUAJ Java e 32-të e Kategorisë

Superiore është e rëndësishme të veçantë për Federatën Shqiptare të Futbollit, e cila e ka vendosur këtë javë si prioritarë në axhendën e saj, pasi sfidat do të luhen të gjitha ditën e shtunë në orën 15:00. Përballjet pritet të jenë të ashpra, pasi ka shumë skuadra që luftojnë për interesa të ndryshme, nga mbijetesa, zona europiane dhe deri te titulli kampion, ndaj në FSHF kanë menduar që të shfrytëzojnë projektin e shkëmbimit të arbitrave, për të sjellë tre gjyqtarë nga Luksemburgu. Dy javë më parë ishte treshja Xhaja, Tartari dhe Ganxhi që gjykuan në Luksemburg, ndërsa tani FSHF-ja ka vendosur të shfrytëzojë këtë raport të mirë me federatën luksemburgase për të sjellë një treshë gjyqtarë, e cila do të arbitrojë ditën e shtunë, por se cila do të jetë sfida që do t'u besohet atyre, kjo ende mbetet e fshehtë.

ELSEID HYSAJ

Ançeloti nuk e preferon, Spaleti e do tek Interi

Karlo Ançeloti nuk e preferon si titullar, Napoli nuk ka ndërmend t'i ofrojë një rinovim të kontratës, por e gjithë kjo tablo në dukje negative nuk është aspak problem për Hysajn për sa kohë ofertat për të nuk mungojnë, për kundraz. Interi vijon të insistojë, Hysaj shihet si futbollisti ideal për t'i besuar krahun e djathtë. Nuk kanë hequr dorë kurë nga kjo ide dhe ky është momenti i duhur për të paraqitur një ofertë konkrete. Sipas "FcInternews.it", Hysaj është shndërruar në prioritet absolut. Anësori i Kombëtares pëlqehet shumë nga Luçiano Spaleti, mbi të gjitha nga ndihmësi i tij Martushielo, i cili ka punuar me Hysajn kur ishte pjesë e Empolit. Palët, përfaqësues të Interit dhe menaxheri i Hysaj kanë vendosur kontaktet e para, pritet që në ditët në vijim kjo tratativë të marrë edhe më shumë formë. Ndryshe nga se ishte parashikuar, ku mendohej se Napoli dhe menaxheri i Hysaj do të gjenin gjuhën e përbashkët për rinovimin e kontratës, gjithçka është ndalur që pas takimit të parë, në këto kushte Interi kërkon të përfitojë për të transferuar Hysajn në Milano. Për mbrojtësin e Kombëtares, Interi do të ishte një hap i madh për karrierën e tij.

PËSON ATAK KARDIAK

Ndalet zemra e Iker Kasijasit, operohet me urgjencë

Iker Kasijas ka trembur të gjithë botën e futbollit, teksa është ushtruar me urgjencë në spital, për shkak të një ataku kardiak që ka tronditur jo pak portierin e Portos gjatë seancës së fundit stërvitore. Ish-gardiani i Real Madridit dhe Kombëtares së Spanjës është shtuar me urgjencë në "CUF Porto Hospital", ndërsa pas ndihmës së parë, gjendja shëndetësore e tij është



normalizuar. Portieri i është nënshtuar ndërhyrjes kirurgjikale dhe mbetet nën vëzhgimin e mjekëve.

"LUFTË" PËR TRAJNERIN

Të gjithë duan Konten në ekip, edhe... Milani


Evetmja gjë e sigurt mbi të ardhmen e Antonio Kontes është fakti se në qershor do të rikthehet të drejtojë një skuadër, por se ku, kjo kërkon ende kohë për të marrë një përgjigje përfundimtare. Të gjithë e duan, por për momentin askush nuk ka bërë një ofertë konkrete. Interi ishte skuadra e parë, e cila dukej më e interesuar për ta transferuar në Milano, por çuditërisht Marota konfirmoi publikisht Spaletin edhe për sezonin e ardhshëm. Juventusit vijon të jetë në kontakte me ish-trajnerin e tyre, nëse Alegri, vendos t'i kapë në befasi. Konte mbetet gjithnjë një



alternativë. Në skenë për të siguruar shërbimet e Kontes ka dalë edhe Milani, fundja "djalli" kërkon një trajner për sezonin e ardhshëm. Leonardo dhe Maldini kanë vendosur menjëherë kontaktet me

ish-trajnerin e Çelstit, sipas mediave italiane gjithçka ka shkuar pozitivisht. Përcaktues në këtë tratativë është fakti se për Konten, Champions League nuk është kusht për të marrë drejtimin e Milanit, thjesht ai dëshiron të rikthehet të drejtojë një skuadër, mundësisht në Itali. Kjo është dëshira e tij, por nëse i vjen një ofertë nga Bayern Mynih, PSG, apo Manchester Junajtid, epike që mund të ndryshojnë trajner në fund të sezonit, e sigurt është se nuk do të thoshte 'jo'.

Fjalëkryqi (1)



33. Janë të përpjeta.
35. Qytet anglez.
36. Louis, poet surrealist.
38. Artet pa re.
39. Matet pa kufij.
40. Gruaja e Ben Hur.
42. Liam i Schindler's list.
45. Të parat në orkestër.
47. Makina Ibiza.
48. Renato, piktor i famshëm italian.
49. Mihali këngëtare lirike.

VERTIKAL

1. Mbyllin fushata.
2. Një pjesë e pikturave.
3. Janë njëvjeçarë
4. Një ngjyhet në tavolocë.
5. Eshhtë katolik ai i papës.
6. Mbyllin portat.
7. Opera e Mascagni-t.
8. Tregohet duke bërë masakra.
10. Janë aftësi prodhuese të fabrikës.
11. Një gjuajtës francez.
12. Eshhtë porti i Durrësit.
13. Kërkojnë origjinën e fjalës të tillë.
16. Fejk pirografi.
19. Një pjesë e aerobisë.
21. U vodhi zjarrin përëndive.
22. Premtojnë të bëhen asa.
23. Mbeten në fund.
26. Rreth pa ekstreme.
28. Rendi pa zë
29. Eshhtë veshje tahitianësh.
30. Tase e volejbolit.
33. Eshhtë shahu i fundit.
34. Kim... Stuart aktor.
35. Frit regjisor.
37. Ai i shtatë është kinemaja.
39. Një pjesë e ansambli.
41. Diftong teatral.
43. Të parat në stacion
44. Qendër në tour
46. Mbarojnë fare.

HORIZONTAL

1. Me të nxjerrin një tapë.
4. Inicialet e Klee piktor.
6. Qiriaçi aktor.
9. Etikë pa kufij.
11. Merren për shembull.
14. Fund janari.
15. Janë edhe ata të skuadrës.
17. Ortolani kompozitor.
18. Ushtrrohet edhe nga bukanierët.
20. Në krye të sondazheve.
21. Janë të ndaluar në kthesë.
23. Entë Rajonale Civile.
24. Gjermania në tabela.
25. Mund të jetë unik.
27. Philippe që qe aktor.
29. Një pjesë e pelegrinazhit.
31. Gjysmë leader.
32. Maten pa zë.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Harris aktor.
3. Termocentrali i shkurtër.
5. Organizata me koska.
10. Një tufë bagëtitsh.
12. Inicialet e Redford.
14. Kështu thonë se bëhet ai që mërztitet.
15. Scarlet e Bashkë e erën.
17. Elvira aktore.
19. Eshhtë Panorama që ke në dorë.
21. Ushtojnë nga "ola".
22. Shtet aziatik.
24. Eshhtë ministri.
25. Në radhtë të parë.
26. G... për njerëzit e FBI.
27. Makina Micra.
31. Mund të jetë proteste.
32. Pasur pa kufij.
33. Gjika e Dora d'Istria.

VERTIKAL


1. Umberto që shkroi Baudolino.
2. Bertë këngëtare italiane.
3. Fillojnë një temë.
4. Një garë në hipodrom.
6. Qe burri i parë.
7. Një ndriçues.
8. Bëjnë shirit me shi.
9. I dha fillin Tezut.
10. Vihen për të mbyllur
11. Para Saint-Germain në futboll.
13. Qëllon në një vend.
16. Eshhtë dosja e të pandehurit.
17. Janë përmasat.
18. Mbush në kufij.
20. I bëjnë duart me ar.
21. Inicialet e dali piktor.
23. Fillojnë argumentin.
28. Makina Ibiza.
29. Emri i Einstein.
30. Ndrriçojnë rrugët.
31. Kim që qe aktore.
32. I hedh i dorzuar.
34. Inicialet e Nolte aktor.
35. Ishin rapsojë e akejeve.
37. Fund shkurti.
40. Van der portier holandez.
44. Fillojnë masat
46. Inicialet e Rohmer.
47. Fillojnë teorikisht.
49. Numër i shkurtër.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 4 | | | | 1 | |
| | | 6 | 1 | | |
| 7 | 2 | | | | 5 |
| | | | | | |
| | | 4 | 3 | 7 | 1 |
| 8 | | | | | 7 |
| | 6 | 8 | | 5 | |
| | | | | 8 | 7 |
| 1 | 2 | 6 | | | |

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | 2 | 3 | 1 | 7 | 4 | 8 | 6 | 5 |
| 7 | 1 | 4 | 6 | 8 | 5 | 2 | 9 | 3 |
| 6 | 5 | 8 | 9 | 3 | 2 | 4 | 1 | 7 |
| 1 | 9 | 5 | 8 | 4 | 7 | 3 | 2 | 6 |
| 8 | 3 | 6 | 2 | 5 | 9 | 7 | 4 | 1 |
| 4 | 7 | 2 | 3 | 1 | 6 | 5 | 8 | 9 |
| 5 | 8 | 1 | 4 | 9 | 3 | 6 | 7 | 2 |
| 2 | 4 | 7 | 5 | 6 | 1 | 9 | 3 | 8 |
| 3 | 6 | 9 | 7 | 2 | 8 | 1 | 5 | 4 |

Argëtim filozofik

- Mos kini frikë, kur ju ecni ngadalë. Kini frikë vetëm kur ju qëndroni

- Kur ligji dhe morali përplasen me njëri-tjetrin, qytetari ka zgjedhjen të humbi perceptimin e moralit apo të humbi respektin e tij për ligjet..

- Një vendim i vogël ka nevojë për logjikë. Një vendim i madh ka nevojë për instinkt.

Thënie të mençura

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|----|---|----|----|----|----|----|----|---|----|----|---|----|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | P | 2 | U | 6 | S | 1 | 15 | 2 | 3 | 5 | 7 | 3 | S | T | A | R | M | E | T | I | K | E | T | A | T | | |
| 2 | 4 | 8 | | | | | | 4 | 7 | | 8 | 6 | | 9 | 1 | A | R | M | I | K | S | T | O | L | I | T | E |
| 6 | 1 | | | 3 | 10 | 9 | 10 | 4 | 1 | 11 | 8 | 5 | L | I | O | R | O | M | I | N | A | T | | | | | |
| 12 | | | | 3 | 8 | 11 | 7 | 4 | 8 | 13 | 8 | 5 | L | O | C | A | B | A | R | E | T | L | A | | | | |
| 5 | 4 | 1 | 3 | 8 | 11 | 7 | 16 | 7 | 13 | 8 | | | A | B | A | T | E | R | I | T | E | A | R | | | | |
| 10 | | | | 3 | 8 | 5 | 8 | 5 | 1 | 11 | 8 | 5 | T | R | I | M | E | R | I | T | E | A | N | E | | | |
| 5 | | | | 10 | 6 | 8 | | | 1 | 5 | | 5 | A | R | T | U | R | O | U | I | M | A | T | | | | |
| 1 | 8 | 4 | | | | | 3 | 4 | 8 | 11 | 1 | 13 | A | R | S | E | N | E | A | R | A | | | | | | |
| | 4 | 1 | 17 | 12 | 8 | 10 | 4 | | 6 | 1 | 9 | | A | D | A | T | M | E | T | R | A | C | | | | | |
| 6 | 5 | 1 | 9 | 10 | 5 | | | | 10 | | 2 | 15 | P | A | K | T | P | I | R | A | T | E | R | I | | | |
| 4 | 2 | 16 | | | | | | | 8 | | 2 | 15 | K | U | A | L | I | T | E | T | I | E | P | | | | |
| 4 | 1 | 17 | 12 | 8 | 4 | 18 | | | | | 5 | 8 | L | E | C | E | P | I | N | A | T | A | | | | | |

- Asnjëherë mos i justifikoni veprimet tuaja. Miqtë tuaj nuk kanë nevojë për këtë, dhe armiqtë tuaj nuk do të ju besojnë gjithsesi.

- E mira ekziston, e keqja duhet të krijohet.
- Liria nuk do të thotë se ju keni kontroll absolut mbi jetën tuaj, do të thotë vetëm që ju mund të zgjidhni atë që dëshironi në një moment të veçantë.

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

F E R M A N I T J N A
A K S I T L O V A L E A
R O N E P F R E N A T
A H T P O K R I T E T D
D E M O S T E N I T K E
D I K A S E R N I T E O R A
A M A T I A T I Z E N E A
D E L E R A T E O E
A R I F E P I T E T E T
I O M A I D M A D H I
S R I R I E L I R E N
T E R R O R I A R E N A T

FJALËKRYQI (2)

L U I S S P A M A L I A
A L K T R O B E R I A
P F E R I O D I K B N A
F I N A L J A A A R N
R E P A R T E T N S I A
T E R E K S I P N
P A R E T T R U K E T I
A R I T R E A L K U P A
S F I T I M E T
T A N D E M N E R U R
A H O T E L E T T R A U
J U K A T E R A R M

